

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6845
E premte, 10 mars 2023
çmimi 0.40

Rusia sulmon infrastrukturën energjetike të Ukrainës me breshëri raketash

FAQE 2



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com


facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KËSHILLI I MINISTRAVE I BE-SË MIRATON ME UNANIMITET LIBERALIZIMIN E VIZAVE PËR KOSOVËN

FAQE 3

NGA 1 JANARI 2024 QYTETARËT E KOSOVËS MUND TË UDHËTOJNË PA VIZA



Ministrat e brendshëm të 27 vendeve të Bashkimit Evropian kanë miratuar të enjten vendimin për liberalizimin e vizave për

Kosovën në takimin e Këshillit të Punëve të Brendshme në Bruksel. Njohësi i çështjeve ndërkombëtare, Demush Shasha, ka thënë se tani ka

mbetur vetëm edhe miratimi në seancën plenare të Parlamentit Evropian në të cilën përsëri pritet përkrahje pothuajse unanime

KOSOVA, NDËR VENDET ME PËRMIRËSIMET MË TË MËDHA NË FUSHËN E LIRISË

FAQE 7



LAJÇAKU NIS VIZITËN DYDITORE NË KOSOVË, TEMË DISKUTIMI RAUNDI I RI I DIALOGUT DHE ASOCIACIONI

FAQE 4-5



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mbx: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË



DY DERBIT E SUPERLIGËS PËRFUNDOJNË PA FITUES

F. 10

AKTUALE



RAMA NËN SHKRUAN MARRËVESHJE PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT "SOLAR 4 KOSOVO"

F. 6

KQZ-ja RRËZON BERISHËN DHE REGJISTRON PD-NË PËR ZGJEDHJET VENDORE NËN PËRFAQËSIMIN E ALIBEAJT

F. 3

LISTA SERBE NUK DO TË MARRË PJESË NË ZGJEDHJET LOKALE NË VERI TË KOSOVËS

F. 5

EKONOMI



LDK-ja: STRATEGJIA E ENERJISË 2022-2031 ËSHTË HARTUAR NË KUADËR TË NJË PROCESI KREJTËSISHT JOTRANSPARENT

F. 8

MINISTRI PEÇI: PËR NËNTË VJET NUK ISHTE APROVUAR ASNJË LIGJ NË SEKTORIN E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

F. 5

SPORT



Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

ShBA-ja dhe Evropa shprehin shqetësim për pasurimin e uraniumit nga Irani

WASHINGTON, 9 MARS - ShBA-ja dhe Evropa kanë ngritur alarmin për Iranin të mërkurën, duke thënë se vendi ka prodhuar një sasi të vogël uraniumi të pasuruar me 84 për qind pastërti, dhe thanë se Irani duhet të japë shpjegim se si ndodhi kjo gjë. Ky nivel i pastërtisë është shumë afër përqindjes që kërkohet për të krijuar armë bërthamore (90 për qind).

Mbikëqyrësi bërthamor i Organizatës së Kombeve të Bashkuara gjeti grimca të uraniumit të pasuruar deri në 83.7 për qind në Fordou, një objekt i gërmuar në një mal, që është lokacioni i dytë i ditur që konverton dhe pasuron vazhdimisht uraniumin deri në 60 për qind. "Për sa iu përket grimcave të zbuluara të uraniumit të pasuruar në 83.7 për qind, të gjithë anëtarët e Bordit duhet të jenë shumë të shqetësuar nga ky zhvillim alarmant", u tha në një deklaratë të ShBA-së në takimin tremujor të Bordit të Guvernatorëve 35-

vendesh të Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë Bërthamore. "Irani duhet të ofrojë bashkëpunim të plotë dhe të menjëhershëm për të sqaruar çfarë ka ndodhur dhe për t'i lehtësuar të gjitha masat e duhura të verifikimit dhe monitorimit që konsiderohen të nevojshme nga Agjencia në mënyrë që çdo ndodhi në të ardhmen të zbulohet menjëherë. Irani duhet të garantojë që një incident i tillë të mos ndodhë më kurrë", u tha në deklaratë.

Gjithashtu, ShBA-ja ngrehi shqetësimin për aktivitetet bërthamore të Iranit duke theksuar faktin që "këto zhvillime të reja ndodhën në një strukturë shumë të fortifikuar që fillimisht ishte ndërtuar fshehurazi dhe vetëm thëllon shqetësimet tona".

Shtetet e Bashkuara dhe tri fuqitë kryesore të Evropës - Britania, Franca dhe Gjermania, të njohura si E3 - janë përmbytur në implementimin e një rezolute që dënon Iranin në këtë takim të



bordit, por bënë të qartë se mund të veprojnë ndryshe në një takim të ardhshëm.

Sipas marrëveshjes të vitit 2015 të Iranit me gjashtë fuqi botërore, Teherani ka reduktuar

programin e tij bërthamor në këmbim të lehtësimin të sanksioneve nga Shtetet e Bashkuara, Bashkimi Evropian dhe Kombet e Bashkuara. Por, ish-presidenti amerikan

Donald Trump u tërhoq nga marrëveshja dhe rivendosi sanksione më 2018, duke nxitur Iranin që ta niste shkëlqen e kufizimeve të vendosura në marrëveshje.

OKB-ja dhe Ukraina bëjnë thirrje për zgjatjen e marrëveshjes së grurit me Rusinë

KIEV, 9 MARS - Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, dhe sekretari i përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB), Antonio Guterres, bënë thirrje të mërkurën për zgjatjen e marrëveshjes me Moskën, e cila lejon Kievin të eksportojë drithëra përmes porteve të Detit të Zi gjatë pushtimit rus.

Presidenti ukrainas Zelensky tha pas bisedimeve me Guterresin në Kiev se marrëveshja për eksportin e drithërave përmes Detit të Zi ishte e nevojshme për botën, ndërsa shefi i OKB-së nënvizoi rëndësinë e saj për



sigurinë globale të ushqimit dhe çmimet e ushqimit në përgjithësi.

Marrëveshja 120-ditore, e ndërmjetësuar fillimisht nga OKB-ja dhe Turqia në korrikun e

vitit të kaluar dhe e zgjatuar në nëntor, do të rinovohet më 18 mars nëse asnjë palë nuk kundërshton. "Dua ta nënvizoj rëndësinë kritike të kalimit të Iniciativës së Detit të Zi më 18 mars dhe të punës për t'i krijuar kushtet për ta mundur përdorimin sa më të madh të infrastrukturës së eksportit përmes Detit të Zi në përputhje me objektivat e nismës", ka thënë Guterres në një konferencë për medie.

Rusia, e cila hoqi një bllokadë në tre porte ukrainase të Detit të Zi sipas marrëveshjes, ka sinjalizuar se pengesat ndaj eksporteve të saj

bujqësore duhet të hiqen përpara se të lejohet që marrëveshja të vazhdojë.

Ukraina dhe Rusia janë të dyja furnizueset kryesore globale të drithërave dhe plehrave.

Fuqitë perëndimore e kanë goditur Rusinë me sanksione të ashpra si përgjigje ndaj pushtimit të saj në Ukrainën fqinje më shumë se një vit më parë.

Ndërsa eksportet ruse të ushqimit dhe plehrave nuk u nënshtrohen sanksioneve, Moska thotë se kufizimet në pagesat e saj në industrinë e logjistikës janë një "pengesë" për dërgesa të tilla.

Rusia sulmon infrastrukturën energjetike të Ukrainës me breshëri raketash

MOSKË, 9 MARS - Rusia lëshoi breshëri raketash mbi gjithë territorin e Ukrainës, duke sulmuar infrastrukturën energjetike të vendit më 9 mars. Autoritetet ukrainase thanë se për shkak të sulmeve u plagosën njerëz dhe u dëmtuan ndërtesa banimi.

Sirenat e sulmeve ajrore u dëgjuan për orë të tëra në të gjithë vendin, përfshi kryeqytetin e Kievit, ku edhe ndodhën shpërthime në dy zona perëndimore. Sistemet e mbrojtjes u aktivizuan në të

gjithë vendin dhe nuk ishte e qartë se sa raketa goditën objektivat.

Në Ukrainën lindore 15 raketa goditën Harkivin dhe rajonin periferik verilindor, duke goditur ndërtesat e banimit.

Guvernatori i rajonit jugor të Odesës, Maksym Marchenko, gjithashtu raportoi për sulme mbi objektet e energjisë dhe ndërtesat e banimit në këtë qytet. Termocentrali bërthamor i Zaporizhjas, i cili është i pushtuar nga forcat ruse, ka humbur energjinë si rezultat i sulmeve me

raketa, sipas operatorit shtetëror bërthamor Energoatom.

Ministri i Energjisë i Ukrainës, Herman Halushchenko, i cilësoi sulmet si "një tjetër sulm masiv barbar në infrastrukturën energjetike të Ukrainës", duke thënë se objektet në rajonet e Kievit, Mykolaivit, Harkivit, Zaporizhjas, Odesës, Dnipropetrovskut dhe Zhytomirit ishin shënjestruar. Hekurudhat e Ukrainës raportuan ndërprerje të energjisë në zona të caktuara, me 15 trena të vonuar deri në një orë.



KËSHILLI I MINISTRAVE I BE-SË MIRATON ME UNANIMITET LIBERALIZIMIN E VIZAVE PËR KOSOVËN

Nga 1 janari 2024 qytetarët e Kosovës mund të udhëtojnë pa viza

Ministrat e brendshëm të 27 vendeve të Bashkimit Evropian kanë miratuar të enjten vendimin për liberalizimin e vizave për Kosovën në takimin e Këshillit të Punëve të Brendshme në Bruksel. Njohësi i çështjeve ndërkombëtare, Demush Shasha, ka thënë se tani ka mbetur vetëm edhe miratimi në seancën plenare të Parlamentit Evropian në të cilën përsëri pritet përkrahje pothuajse unanime

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 9 MARS - Këshilli i Ministrave i Bashkimit Evropian ka miratuar të enjten me unanimitet liberalizimin e vizave për Kosovën. Ministrat e kanë miratuar këtë vendim "në lexim të parë", pa diskutime, pasi për këtë më herët në takim të ambasadorëve ishin pajtuar përfaqësuesit e përhershëm të vendeve anëtare. Njohësi i çështjeve ndërkombëtare, Demush Shasha, ka thënë se është ndjenjë e veçantë të shohësh se si një sagë 10-vjeçare përfundon brenda 10-sekondash të një mbledhjeje. "Tani ka mbetur vetëm edhe miratimi në seancën plenare të Parlamentit Evropian, ku pritet përkrahje, përsëri pothuaj unanime", ka shkruar Shasha. Sipas këtij vendimi, data e nisjes së


liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës do të jetë koha kur të jetë tërësisht funksional sistemi i autorizimit dhe verifikimit të udhëtimeve (ETIAS), apo jo më vonë se 1 janari i vitit 2024. Deri vonë ishte besuar se hyrja në fuqi e këtij sistemi do të jetë më 1 nëntor të këtij viti, por ky afat është shtyrë për vitin 2024. Hyrja në fuqi e këtij sistemi vitin që vjen është vendosur si datë e re në faqen zyrtare të sistemit ETIAS. Kur të hyjë në fuqi ky sistem, ata që duan t'i vizitojnë vendet e BE-së pa viza, duhet paraprakisht të regjistrohen përmes tij dhe më pas marrin një autorizim i cili është i vlefshëm për tre vjet. Për këtë qytetarët do të duhet të paguajnë 7 euro, por ata të moshës nën 18 dhe mbi 70 vjeç mund ta bëjnë falas. Diplomatat në BE thonë se



aktualisht gjithçka në procesin e liberalizimit të vizave për Kosovën po shkon sipas planit dhe se afati i hyrjes në fuqi mbetet 1 janari i vitit të ardhshëm. Burime në BE pohojnë se tashmë nuk shohin ndonjë pengesë në këtë proces, i cili pritet të finalizohet formalisht deri në fund të presidencës suedeze të BE-së që përfundon më 31 qershor. Vendimi, thonë ata, do të jetë gati

për të hyrë në fuqi, nëse jo më herët, atëherë më 1 janar të vitit 2024. Besnik Bislimi, zëvendëskryeministër i Kosovës, ka theksuar se ky është një hap i rëndësishëm drejt liberalizimit të vizave për qytetarët e Republikës së Kosovës. "Me votimin unanimit dhe miratimin e sotëm të Këshillit të Ministrave të BE-së, për liberalizimin e vizave për Kosovën,

shkojmë drejt fazave të fundit dhe përfundimit të procesit. Procedurat e mbetura janë miratimi nga Parlamenti Evropian, nënshkrimi dhe publikimi në gazetën zyrtare të BE-së. Presim që këto hapa të përfundojnë zyrtarisht brenda pjesës së parë të këtij viti. Pritja e gjatë po shkon hap pas hapi drejt fundit, ku qytetarët do të mund të lëvizin pa viza nga 1 janari 2024", ka deklaruar Bislimi.



Rama: BE-ja po e heq nga vetja njollën e trajtimit të Kosovës si një vend jashtë Evropës

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka thënë se më në fund Bashkimi Evropian po e heq nga vetja njollën e trajtimit të Kosovës si një vend jashtë Evropës. "Një hap i vonuar padrejtësisht me vite u hodh sot nga BE-ja, e cila, më në fund, po e heq nga vetja njollën e turpit të trajtimit të Kosovës si të ishte një vend jashtë Evropës! Urime jo vetëm Kosovës, po edhe Bashkimit Evropian!", ka shkruar Rama në "Facebook". Edhe eurodeputeti austriak Lukas Mandl ka përshëndetur

vendimin e Këshillit të Ministrave të BE-së, duke thënë se ky është një hap shumë i vonuar. "Kjo është shumë e vonuar, megjithatë kemi arsye për të qenë të lumtur. Por, ne, gjithashtu, duhet ta pyesim veten pse disa vendime që e bëjnë jetën më të mirë për shumë njerëz dhe nuk do të dëmtonin askënd ndonjëherë zgjasin kaq shumë në BE. Ne duhet t'i kapërcejmë qasjet e tilla ideologjike. Le t'i shërbejmë Evropës dhe evropianëve", ka shkruar Mandl në "Twitter".

KQZ-ja rrëzon Berishën dhe regjistron PD-në për zgjedhjet vendore nën përfaqësimin e Alibeajt

TIRANË, 9 MARS - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në Shqipëri regjistroi të enjten Partinë Demokratike nën përfaqësimin e drejtuesit të deleguar Enkelejd Alibeaj si konkurrues në zgjedhjet vendore të 14 majit, duke rrëzuar kërkesën e ish-kryeministrit Sali Berisha, i cili pretendoi regjistrimin në zgjedhje me të njëjtin emërtim subjekti. Pasi dëgjoi për afro dy orë përfaqësuesit ligjorë, që mbrojtën dy kërkesat me të njëjtin emër subjekti, komisionari i zgjedhjeve,

Ilirian Celibashi, vendosi ta pranojë kërkesën e paraqitur nga Alibeaj, i autorizuar si drejtues nga kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha. Komisionari Celibashi theksoi se kërkesa e paraqitur nga Alibeaj plotëson kriteret dhe është e bazuar në Ligjin për Partitë Politike dhe në regjistrimet e gjykatës së Tiranës. Ai la 48 orë kohë për plotësimin e detajeve në dokumente, që u vërejtën si paqartësi. Ndërsa kërkesa e ish-kryeministrit Sali Berisha u rrëzua, sepse

nuk bazohej në ligj dhe nuk kishte regjistrime certifikuese nga gjykata. Përfaqësuesit ligjorë përsëritën para Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të njëjtat argumentime që kanë shfaqur edhe në përballjet e tyre përpara gjykatës së shkallës së parë dhe të Apelit. Apeli ktheu për rigjykim në shkallën e parë çështjen e përfaqësimit të Partisë Demokratike, duke rrëzuar vendimin e mëparshëm, që njihte ish-kryeministrin Berisha kryetar të kësaj partie.





Lajçaku nis vizitën dyditore në Kosovë, temë diskutimi raundi i ri i dialogut dhe Asociacioni

I dërguari i Bashkimit Evropian për dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë, Miroslav Lajçak, të enjten ka nisur vizitën dyditore në Prishtinë, që synim ka përgatitjet për raundin e ri të dialogut dhe Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe. Lajçaku është takuar me presidenten e Kosovës, Vjosa Osmani, pastaj edhe me kryeministrin Albin Kurti. Takimet janë zhvilluar pa praninë e medieve

EPOKA E RE**Mal QORRAJ**

PRISHTINË, 9 MARS - I dërguari i Bashkimit Evropian për dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë, Miroslav Lajçak, të enjten ka nisur vizitën dyditore në Prishtinë, që synim ka përgatitjet për raundin e ri të dialogut dhe Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe.

Lajçaku gjatë vizitës në Prishtinë fillimisht është takuar me presidenten e Kosovës, Vjosa Osmani, pastaj edhe me kryeministrin Albin Kurti. Takimet janë zhvilluar pa praninë e medieve.

Gjatë qëndrimit në Prishtinë ai do të takohet edhe me përfaqësuesit e partive opozitare. Sipas BE-së, pas qëndrimit në Kosovë, më 13

dhe 14 mars Lajçaku do të vizitojë Beogradin.

Qëndrimet kundërshtuese të partive opozitare, Partisë Demokratike të Kosovës dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës, ndaj propozimit të Bashkimit Evropian për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë - Serbi, kanë krijuar shqetësim për partnerët perëndimorë të Kosovës.

Propozimi evropian synon t'i çojë palët drejt një marrëdhënieve të bashkuara dhe normalizimit të marrëdhënieve Kosovë - Serbi, kanë krijuar shqetësim për partnerët perëndimorë të Kosovës. Njohësi i zhvillimeve politike, Artan Muhaxhiri, vlerëson se presioni i partnerëve perëndimorë, i cili deri vonë ka qenë i drejtuar kah Qeveria e Kosovës për çështjet që

ndërlidhen me dialogun me Serbinë, tashmë do të orientohet kah partitë opozitare lidhur me propozimin e BE-së.

BE-ja tashmë ka konfirmuar se kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, dhe presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, do të takohen më 18 mars në Ohër të Maqedonisë së Veriut, për të diskutuar mbi planin e zbatimit të propozimit të BE-së për normalizim.

Gjatë një vizite në një biznes në Graçanicë më 8 mars, Kurti tha për gazetarët se po vazhdojnë përgatitjet për takimin e radhës të dialogut të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian, që do të mbahet më 18 mars në Maqedoninë e Veriut. "Pritjet tona janë që do të vazhdojnë përgatitjet për takimin e 18 marsit, që do të mbahet në Maqedoninë e Veriut, në Ohër. Dhe do të shohim se si do të mund t'ia bashkëngjisim propozimit të dakorduar evropian edhe një plan të mirëfilltë zbatimi që duhet të karakterizohet nga gjithëpërfshirja dhe nga efikasiteti", tha Kurti.

Një zëdhënës i Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) në Prishtinë ka deklaruar për disa medie në Kosovë se pikëpamjet e këtyre dy partive "nuk përputhen me mbështetjen e ShBA-së për propozimin". "Jemi të

shqetësuar me deklaratat e bëra nga drejtues dhe zyrtarë të partive opozitare që shprehin kundërshtimin e tyre ndaj propozimit të BE-së", thuhet në deklaratën e publikuar më 6 mars.

Një ditë më pas ambasadori i Gjermanisë në Prishtinë, Jorn Rohde, duke folur për transmetuesin publik, "Radio Kosova", ka thënë se pret që partitë opozitare të jenë konstruktive lidhur me planin e BE-së për dialogun dhe se ato duhet të tregojnë "përgjegjësi politike shtetërore".

Dy partitë opozitare, PDK-ja dhe LDK-ja, sërish kanë shprehur rezervat e tyre lidhur me këtë propozim.

Për të biseduar lidhur me zhvillimet në dialogun Kosovë - Serbi, ambasadori i Francës, Olivier Guerot, ka takuar më 8 mars kryetarin e Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi.

Në "Facebook", Krasniqi ka thënë se lidhur me procesin ia ka shprehur ambasadorit Guerot "rezervat që i kemi shfaqur edhe publikisht lidhur me marrëveshjen aktuale të prezantuar", me fokus te mungesa e "njohjes së ndërsjellë si rezultat përfundimtar i procesit të dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë".

Nënkryetari i LDK-së, Lutfi

Haziri, ka theksuar për "Radion Evropa e Lirë" shqetësimin e shprehur nga partnerët perëndimorë, në veçanti të ShBA-së e sheh si të bazuar. Këndvështrimi i këtyre shqetësimeve, sipas tij, ka të bëjë me mungesën e konsensusit në Kosovë lidhur me propozimin e BE-së për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë - Serbi. Por, sipas tij, për mungesën e këtij konsensusi përgjegjësi i takon më së shumti kryeministrin të Kosovës, Albin Kurti, dhe presidentes Vjosa Osmani sepse, siç thotë ai, atyre u ka munguar angazhimi dhe vullneti politik për të ndërtuar konsensus sa më të gjerë lidhur me proceset e mëdha, në veçanti për dialogun me Serbinë. "Ne po e kuptojmë rolin dhe qëndrimin amerikan dhe na është thënë. Ne më shumë kemi pasur takime me emisarin amerikan [për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar] sesa me kryeministrin dhe më shumë kemi pasur takime me ambasadorin amerikan [në Kosovë, Jeff Hovenier] sesa me kryeministrin dhe presidenten bashkë. Por, kjo është gjendja në të cilën LDK-ja e ka rishikuar dhe e ka riformuluar [qëndrimin]. Parimisht, ne nuk kemi ndryshuar raport dhe qëndrim. Ka ndryshuar qëndrimin kryeministri", thotë

Ministri Peci: Për nëntë vjet nuk ishte aprovuar asnjë ligj në sektorin e bujqësisë, pylltarisë dhe zhvillimit rural

PRISHTINË, 9 MARS - Ministri i Bujqësisë, Faton Peci, ka thënë se për nëntë vjet me radhë në sektorin e bujqësisë, pylltarisë dhe zhvillimit rural nuk ishte aprovuar asnjë ligj. "Vetëm dje e sot kaluan leximin e dytë në Kuvendin e Republikës së Kosovës dy ligje bazike. Imagjinoni! Territori i Kosovës

është mbi rreth 40 për qind i mbuluar nga pyjet dhe deri më tani nuk ka pasur vullnet politik që ky sektor shumë i rëndësishëm socio-ekonomik e ambiental të rregullohet me ligj adekuat", ka shkruar Peci në "Facebook".

Ai ka bërë me dije se në seancën e Kuvendit të enjten kaloi në

lexim të dytë Ligji për Pyje. "Ndërsa gjatë seancës së djeshme, kaloi leximin e dytë ligji për bujqësi dhe zhvillim rural i cili do ta rregullojë këtë sektor dhe do t'i shërbejë zhvillimit dhe avancimit të mëtutjeshëm të bujqësisë si veprimtari", ka thënë ministri Peci.



Haziri. Haziri shton se LDK-ja e mbështet procesin e dialogut por, sipas tij, kryeministri e ka dëmtuar procesin për shkak se më nuk po bisedohet për njohje të ndërsjellë me Serbinë. Ai thekson se kryeministri Kurti nuk i ka ftuar partitë opozitare "për të dhënë sqarime se çfarë ka arritur, cilat janë vështirësitë dhe pritjet lidhur me

propozimin e BE-së për normalizim" dhe këtë nuk e ka bërë as në Kuvendin e Kosovës ku ishte i ftuar me mocion. Njohësi i proceseve politike, Artan Muhaxhiri, vlerëson se qëndrimet kundërshtuese të PDK-së dhe LDK-së ndaj propozimit evropian për normalizimin e raporteve Kosovë - Serbi janë paradoksale. "Trashëgimia në dialog ka qenë 100 për qind në harmoni me

idetë evropiane dhe planet e deritashme, të cilat nuk dallohen aq shumë me planin franko-gjerman [propozimin e BE-së]. Pra, ai nuk është shumë i ndryshëm nga marrëveshjet e vitit 2013 dhe vitit 2015 të cilat janë pranuar nga PDK-ja dhe LDK-ja dhe janë votuar në Kuvend", thotë Muhaxhiri. Ai shton se të dy këto parti në vazhdimësi e kanë kritikuar kryeministrin Kurti për

mungesë të realizimit dhe pragmatizmit në raport me projektet e mëdha ndërkombëtare për Kosovën derisa ai po përballej me presionin ndërkombëtar. Kritika të tilla Kurti kishte marrë edhe në kohën derisa partia e tij, Lëvizja Vetëvendosje, ishte në opozitë. "Tani kur kryeministri Kurti shfaqet pragmatik dhe bashkëpunues, këto dy parti i ndryshojnë pozicionet. Duket i

palogjikshëm ky kundërshtim kaq radikal i këtyre dy partive në një moment kur presionet janë jashtëzakonisht të mëdha. Është e pritshme që këto presione, nga kryeministri Kurti, i cili tashmë është shndërruar në një aktor tejet konstruktiv, të kalojnë në drejtim të opozitës kosovare, pastaj të fillojë një betejë e re ndërmjet përfaqësuesve të opozitës, ShBA-së si dhe BE-së", vlerëson Muhaxhiri.



Tahiri: Kemi hyrë në vitin e kapitullimit ekonomik

PRISHTINË, 9 MARS - Shefi i grupit parlamentar i AAK-së, Besnik Tahiri, ka thënë se Qeveria e Kosovës ka rënë në kurthin e diskutimit politik dhe dialogut e kjo, sipas tij, po çon në neglizhencën totale të ekonomisë, mirëqenies dhe gjendjes sociale. "Shumë politikë, pak ekonomi. Pak jetë, shumë politikë! Kemi hyrë në vitin e kapitullimit ekonomik", ka thënë ai në seancën e Kuvendit të enjten.

Tahiri ka theksuar se është e papranueshme që i gjithë diskursi publik dhe vendimet në qeveri të lidhen me politikën dhe temat e larta dhe asnjë veprim serioz të mos jetë në dobi të shoqërisë dhe qytetarëve. "Është e pakuptimtë që politika dhe temat e larta të kthehen vetëm në qëllim të qeverisë. Në qoftë se i shohim trendet globale të inflacionit, shihet se inflacioni gjithandej botës ka rënë,

ndërsa në Kosovë është ngritur. Në janar të këtij viti inflacioni ka shënuar në 12.1 për qind përdërisa, për çudi, çmimet e derivateve kanë rënë, ndërsa produktiviteti i ekonomisë është në rënie. Kjo vjen si rrjedhojë e neglizhencës totale dhe injorimit të ekonomisë dhe politikave që e forcojnë shtetin në këtë aspekt", ka thënë ai, duke shtuar se ekonomia dhe bizneset janë para kolapsit.



Rama nënshkruan marrëveshje për financimin e projektit “Solar 4 Kosovo”

PRISHTINË, 9 MARS - Kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, kryeshefi ekzekutiv i NP “Termokos”, Fisnik Osmani dhe drejtori për bashkëpunim i Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh), Sergiy Maslichenko, nënshkruan marrëveshjen për financimin e projektit “Solar 4 Kosovo”. Bazuar në këtë marrëveshje, BERZh-i do të financojë me një kredi prej 23.2 milionë eurosh projektin “Solar 4 Kosovo”, i cili do të jetë një nga më të mëdhenjtë në Evropë dhe i pari në rajon, që do të sigurojë kapacitete shtesë termike përmes shfrytëzimit të energjisë diellore.

Nëpërmjet vendosjes së paneleve solare në një hapësirë prej 58 mijë metrave katrorë do të rriten kapacitetet për 50 MW për të furnizuar me ngrohje edhe 12 mijë konsumatorë të rinj. Realizimi i këtij projekti do ta mundësojë zgjerimin e rrjetit të ngrohjes edhe për një pjesë të lagjes “Arbëria” dhe “Tophane”. Projekti “Solar 4 Kosovo” financohet nga grantet e Qeverisë gjermane dhe BE-së nëpërmes Bankës Gjermane për Zhvillim (KfW) në vlerë të 31.6 milionë eurove dhe 21.5 milionë eurove, si dhe nga një kredi e butë nga BERZh-i në vlerë të 23.2 milionë eurove.



Një muaj paraburgim për serbin e dyshuar për krime lufte në Kosovë



PRISHTINË, 9 MARS - Gjykata Themelore në Prishtinë ka caktuar masën e paraburgimit prej një muaji për Z. A., që dyshohet për krime lufte kundër popullatës civile gjatë luftës së fundit në Kosovë.

Z. A., i nacionalitetit serb, u arrestua më 7 mars dhe, sipas Prokurorisë Speciale të Kosovës, ai dyshohet se në mars të vitit 1999, në Stacionin Policor në Kamenicë, si person zyrtar, së bashku edhe me policë të tjerë serbë, fillimisht kishin rrahur “me shufra gome dhe shqelma”

dhe më pas kishin torturuar “në mënyrë çnjerëzore” të dëmtuarin me initiale B. M. Sipas Prokurorisë Speciale, i dëmtuari kishte pësuar lëndime të rënda dhe i ishte “kanosur seriozisht jeta” gjatë dhunës së ushtruar që thuhet se ka zgjatur për një orë e gjysmë.

I arrestuari, po ashtu, dyshohet se në periudhën shkurt-mars 1999 ka marrë pjesë në “dëbimin dhe shpërnguljen me dhunë të qytetarëve të Kamenicës me rrethinë, pastaj ka filluar të bëjë plaçkitjen e shtëpive e, më pas,

me qëllim të dëmtimit të pronës së shqiptarëve, ai ka vënë zjarrin si dhe ka marrë pjesë në keqtrajtimin e civilëve shqiptarë”.

Kundër vendimit të 8 marsit të Gjykatës Themelore të Prishtinës palët mund të ushtrojnë ankesë në Gjykatën e Apelit. Në luftën e fundit në Kosovë më 1998-99 janë vrarë mbi 13 000 civilë dhe mijëra të tjerë janë zhdukur. Mbi 1 600 persona vazhdojnë të jenë ende të pagjetur, pjesa më e madhe e tyre shqiptarë.

Po vazhdojnë punimet për rregullimin e rrugës “Ibrahim Mazreku” në Malishevë

MALISHEVË, 9 MARS - Ndërtimi i rrugës “Ibrahim Mazreku” me tërë infrastrukturën përcjellëse të saj është duke vazhduar sipas dinamikës së paraparë për realizimin e projektit, njëkohësisht është duke vazhduar edhe lirimi i hapësirës publike përgjatë kësaj rruge. Punimet në këtë rrugë të enjten i ka parë nga afër edhe nënkryetari i komunës së Malishevës, Vesel Krasniqi, së bashku me drejtorët e drejtorive përkatëse të urbanizmit dhe të inspektoratit, Avdi Morina dhe Hafir Rexha, si dhe zyrtarët përgjegjës për realizimin e këtij projekti. “Kam parë nga afër

punimet në rrugën ‘Ibrahim Mazreku’ dhe jam njoftuar nga përgjegjësit për ecurinë e punimeve të deritanishme. Mund të them se jemi të kënaqur me ecurinë e punimeve dhe realizimin e projektit dhe besojmë shumë se i tërë projekti do të përfundojë sipas planifikimit. Ju jemi shumë mirënjohës dhe i falënderojmë të gjithë qytetarët, të cilët e kanë mirëpritur këtë projekt dhe janë duke bashkëpunuar për realizimin e tij”, ka thënë nënkryetari Krasniqi gjatë inspektimit të punimeve në këtë rrugë.



Drejtori i ri i OSBE-së ofron bashkëpunim me komunën Gjilanit

Gjilan, 9 mars - Kryetari i komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, ka prituri në takim njoftues drejtorin e ri të Organizatës së Sigurisë dhe

Bashkëpunimit në Evropë (OSBE), Igli Totozani. Në këtë takim u bisedua për marrëdhëniet dhe thellimin e mëtutjeshëm të

bashkëpunimit në mes të komunës së Gjilanit dhe OSBE-së. Pas marrjes së detyrës së re, Totozani ka shprehur gatishmërinë për

mbështetje për komunën e Gjilanit, ndërsa kryetari Hyseni u shpreh falënderues për bashkëpunim dhe mbështetje.



Liria në botë, Kosova, ndër vendet me përmirësimet më të mëdha



PRISHTINË, 9 MARS - Në raportin më të ri të organizatës Freedom House për lirinë në botë, Kosova renditet e treta në listë për përmirësimet e bëra në këtë fushë. Edhe pse mbetet në kategorinë e vendeve pjesërisht të lira, Kosova vlerësohet me plus 4 pikë për përmirësimin e të drejtave politike dhe të lirisë civile.

Raporti i publikuar më 9 mars vë në dukje se përmirësimet më të mëdha gjatë vitit 2022 janë bërë në Kolumbi, e cila vlerësohet me +6 pikë. Pas saj renditet Sllovenia me +5 pikë, pasojnë Kosova, Kenia dhe San Marino me nga +4 pikë. Në kategorinë e vendeve pjesërisht të lira janë edhe vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor: Shqipëria, Mali i Zi, Serbia, Maqedonia e Veriut dhe Bosnjë-Hercegovina.

Freedom House vlerësoi 210 vende dhe territore në gjithë botën, prej të cilave 84 vende janë të lira, ashtu si edhe një territor, 54 vende dhe katër territore janë pjesërisht të lira dhe 57 vende dhe 10 territore janë jo të lira.

Burkina Faso, me dy grushtshtete në vitin 2022, pësoi rënien më të madhe të pikëve. Ajo humbi 23 pikë në

shkallën 100-pikëshe të raportit, e ndjekur nga Ukraina, e cila humbi 11 pikë si rezultat i pushtimit rus.

Rënie pësuan edhe Tunizia, Nikaragua, Guinea, El Salvadori, Hungaria dhe Rusia. "Hendeku midis numrit të vendeve që regjistruan përmirësime të përgjithshme në të drejtat politike dhe liritë civile dhe atyre që regjistruan rënie të përgjithshme në vitin 2022 ishte më i ngushti që ka qenë ndonjëherë në 17 vjetët e fundit", thuhet në raport.

Përmirësime bënë 34 vende, ndërsa rënie shënuan 35. Sipas raportit, përmirësimet, mes të tjerash, u nxitën nga zgjedhjet më konkurruese, si dhe nga heqja e kufizimeve që lidheshin me pandeminë e koronavirusit dhe që ndikuan në mënyrë joproporcionale lirinë e grumbullimit dhe lirinë e lëvizjes.

Pengesat më serioze për lirinë dhe demokracinë, sipas raportit, ishin rezultat i luftërave, grushtshteteve dhe sulmeve ndaj institucioneve demokratike nga pushtetarët joliberalë. "Regjimi autoritar i Rusisë nisi pushtimin e plotë të Ukrainës, në përpjekje për ta shuar përparimin demokratik

të atij vendi, të arritur me vështirësi", thuhet në raport. Sipas tij, "grushtshtetet dhe përpjekjet e tjera për t'i minuar qeveritë përfaqësuese, destabilizuan Burkina Fason, Tunizinë, Perunë dhe Brazilin". Freedom House kujton se regjimi taliban i Afganistanit i ndaloi vajzat të arsimoheshin në mes të një krize të vazhdueshme ekonomike dhe humanitare. "Qeveritë dhe fuqitë okupuese përdorën dhunë dhe mjete të tjera për t'i shkatërruar kulturat dhe për ta ndryshuar përbërjen etnike të popullsisë në 21 vende dhe territore, përfshirë Ukrainën, Etiopinë dhe Mianmarin", thekson raporti i organizatës me seli në Nju-Jork.

Aty thuhet se viti 2022 solli pak a shumë të njëjtën gjë në lidhje me lirinë e medieve e cila u vu nën presion në së paku 157 vende dhe territore.

Liria e shprehjes personale, sipas raportit, pësoi, gjithashtu, për shkak të shkeljeve të privatësisë, ngacmimeve dhe frikësimeve. Megjithatë, bota është dukshëm më e lirë sot sesa ishte 50 vjet më parë, thekson Freedom House.

Në vitin 1973, kujton

organizata, 44 nga 148 vende u vlerësuan si të lira. Sot, sipas saj, 84 nga 195 vende e kanë atë status - plus një territor. "Protestat e vazhdueshme kundër represionit në Iran, Kubë, Kinë dhe vende të tjera autoritare sugjerojnë se dëshira e njerëzve për liri është e

guximshme dhe se asnjë pengesë nuk duhet të konsiderohet si e përhershme", thuhet në raport.

Nga 57 vendet që u cilësuan si jo të lira, në fund të listës janë: Sudani Jugor, Siria, Turkmenistani, Eritrea dhe Koreja e Veriut. /Rel

Demush Shasha: Tri mesazhe të rëndësishme nga publikimi i Freedom House

Njohësi i çështjeve ndërkombëtare, Demush Shasha, ka komentuar publikimin e raportit të Freedom House. Ai ka theksuar se janë tri mesazhe të rëndësishme nga publikimi i Freedom House për liritë politike dhe civile në botë. "1. Kosova ka bërë progres rekord vjetor demokratik në historinë e saj dhe ka zënë vendin e tretë në botë për progresin më të madh vjetor demokratik. 2. Demokracitë e Kosovës dhe të Serbisë janë duke shkuar në drejtime krejtësisht të kundërta. Kosova çdo vit më e lirë dhe më e drejtë, Serbia çdo vit më

pak e lirë dhe më pak e drejtë. 3. Duke shikuar dhjetë vitet e fundit vetëm Kosova dhe Maqedonia e Veriut kanë sot demokracitë më të mira se para dhjetë vitesh, Shqipëria nuk ka bërë asnjë progres në këtë periudhë; ndërsa Serbia, Mali i Zi dhe Bosnja kanë sot demokracitë më të dobëta se para dhjetë vitesh. Në veçanti Serbia ka bërë regres duke rënë në renditje për plot 18 vendesh. Një degradim kaq i thellë demokratik e ka sjellë Serbinë në grup me Afganistanin dhe Mjanmarin", ka shkruar Shasha në "Facebook".



Lista Serbe nuk do të marrë pjesë në zgjedhjet lokale në veri të Kosovës

PRISHTINË, 9 MARS - Lista Serbe, partia më e madhe e serbëve të Kosovës, ka bërë me dije se nuk do të marrë pjesë në zgjedhjet e jashtëzakonshme lokale të 23 prillit në katër komuna në veri të Kosovës, pasi ka thënë se nuk janë përmbushur kërkesat që i kanë shtyrë ata të largohen nga institucionet e vendit. "Kjo e bën më se të qartë se Prishtina dhe Komisioni i saj Qendror i Zgjedhjeve po

përpiqen që në mënyrë të njëanshme të organizojnë zgjedhje në veri të Kosovës dhe Metohisë, kundër vullnetit të qytetarëve, pa respektuar interesat legjitime të popullit serb", thuhet në njoftimin e bërë nga kjo parti. Zgjedhjet e jashtëzakonshme në komunat në veri të Kosovës po mbahen pasi kryetarët e komunave që ishin nga radhët e Listës Serbe dhanë dorëheqje në nëntor të vitit të

kaluar në kuadër të largimit kolektiv të punëtorëve të etnisë serbe nga institucionet e Kosovës. Ky veprim u ndërmor në shenjë kundërshtimi ndaj vendimit të Qeverisë së Kosovës për ta kryer procesin e reregjistrimit të targave serbe, në targa të Kosovës, vendim i cili më pas u pezullua me një marrëveshje me Serbinë në kuadër të dialogut të lehtësuar nga Bashkimi Evropian.



LDK-ja: Strategjia e Energjisë 2022-2031 është hartuar në kuadër të një procesi krejtësisht jotransparent

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 9 MARS - Visar Azemi nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) në një konferencë për medie ka thënë të enjten se Strategjia e Energjisë 2022-2031, dokumenti më me rëndësi për zhvillim të vendit, është hartuar në kuadër të një procesi krejtësisht jotransparent dhe jogjithëpërfshirës. Ai ka thënë se strategjia e re e energjisë është strategji e thëngjillit dhe mungesës së vizionit "Kosova në të gjitha krizat energjetike gjatë dy vjetëve të fundit është futur pa pasur strategji të aprovuar dhe ide se si t'i menaxhojë këto kriza të cilat rezultuan me rritje të çmimit të energjisë elektrike. Kjo strategji u vonua me muaj të tërë dhe u harrua tërësisht, ndërsa dje u kalua me urgjencë në Kuvend. Kjo qartazi po bëhet për ta mbuluar dështimin e këtij dokumenti strategjik dhe ballafaqimin me problemin

kryesor, atë të uljes së konsumit të energjisë elektrike që përdoret për ngrohje gjatë muajve të dimrit dhe jo vetëm", ka thënë Azemi. Ai ka thënë se edhe pse në dokument konstatohet saktë që sektori i ngrohjes konsumon më shumë energji se çdo sektor tjetër i sistemit elektroenergjetik të Kosovës, fatkeqësisht kjo strategji nuk e adreson këtë si çështje dhe kjo nuk reflekton në programet e propozuara nga kjo qeveri. "Në këtë dokument thuhet se ngrohja do të trajtohet në kuadër të strategjisë për ngrohje. Paramendojeni, strategji e energjisë që nuk trajton problemin kryesor të konstatuar në dokument. Kjo është njëjtë sikurse kur një mjek diagnostikon sëmundjen, por terapinë e ofruar e ka për diçka krejt tjetër. Pra, nuk mund të ketë strategji të mirëfilltë të energjisë nëse problemi kryesor me energji e që është energjia termike trajtohet ndaras strategjisë për energji.



Bashkimi Evropian dhe ShBA-ja në kuadër të tranzicionit prej djegies së lëndëve fosile deri në një koncept komplet të gjelbër janë duke e përdorur gazin. Pra, gazi është gjerësisht i njohur si mjet tranzicioni drejt dekarbonizimit të sektorit të energjisë për shkak të dendësisë së lartë të energjisë dhe ndikimit të vogël në mjedis. Të njëjtën

alternativë e kanë ofruar edhe për shtetin tonë dhe kjo duhet shqyrtuar me seriozitet nëse dëshirojmë të krijojmë stabilitet në furnizim dhe siguri energjetike", ka thënë ai. Azemi ka theksuar se rrjedhimisht gazin duhet parë si një mjet tranzicioni për prodhim të energjisë elektrike dhe gjithsesi edhe si mundësi për të ndërtuar ngrohtore

qendrore në qytetet e mëdha të Kosovës. "Kjo do ta ulte në masë të madhe kërkesën për ngrohje me energji elektrike. Më tutje, gazi natyror dhe shtrirja e gazifikimit nëpër qendrat kryesore industriale krijon potencial të madh për investime me prioritet të lartë jo vetëm ekonomik, por edhe strategjik", ka thënë zyrtari i LDK-së, Visar Azemi.

Kurti takoi të punësuarat në fabrikën e mbështetur me pakon e ringjalljes ekonomike

PRISHTINË, 9 MARS - Kryeministri i vendit, Albin Kurti, i shoqëruar nga ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, ka vizituar fabrikën "Premium Bakery". Aty ka takuar dhe bashkëbiseduar me të punësuarat e mbështetura nëpërmjet Pakos së Ringjalljes Ekonomike.

Kryeministri pa nga afër punën e fabrikës si dhe u njoftua nga drejtuesi Besart Shatri me procesin e punës, prodhimin dhe rritjen e punësimit në këtë fabrikë. Ai tha se kjo kompani karakterizohet me prodhime shumë cilësore dhe me rritje të prodhimitarisë e, kohën e fundit, edhe me shtim të eksportit. "Diskutua se si mund ta ndihmojnë këtë fabrikë, ashtu që të rritet prodhimtaria, të rritet



punësimi, ku duhet theksuar se shumë institucione shtetërore, si për shembull spitalet edhe burgjet, furnizohen me prodhimet e

"Premium Bakery", ka deklaruar Kurti, duke shtuar se shteti si garantues i ligjshmërisë, si mbështetës i zhvillimit, do të bashkëpunojë

sa më ngushtë me sektorin privat, që të rriten ndërmarrjet, të rritet ekonomia, rrjedhimisht edhe mirëqenia e qytetarëve.

Ai shtoi se kjo është një ndërmarrësi shumë e suksesshme "ndaj së cilës jemi falënderues për produktet në tryezën tonë, gjithashtu edhe për kontributin në ekonominë tonë". "Janë mbi 200 punëtorë direktë në këtë fabrikë, por edhe 80 të tjerë indirekt të cilët punojnë në dy ndërrime, ndërkaq gjatë verës në tri ndërrime, me ç'rast gjithsej i ka 100 produkte të ndryshme, ku janë gjashtë linja të prodhimit, në gjithsej mbi 1 700 pika të shitjes anembanë Kosovës që furnizohen. Nëse këtu përfshihen edhe lokalet, atëherë bëhen mbi 3 000. Një ndërmarrësi shumë e suksesshme ndaj së cilës jemi falënderues për produktet në tryezën tonë, por edhe për kontributin në ekonominë tonë", ka thënë kryeministri Kurti.

Hoti: Sot bizneset private detyrohen të importojnë qymyr nga jashtë


PRISHTINË, 9 MARS - Ish-kryeministri Avdullah Hoti ka thënë se një numër i bizneseve në Kosovë e përdorin qymyrin për ngrohje të hapësirave të punës apo në teknologjinë e prodhimit. "Zakonisht këto biznese qymyrin e kanë blerë nga ndërmarrja 'Kosova Thëngjilli', e cila funksionon si shoqëri aksionare. Kjo ndërmarrje e ka blerë qymyrin nga KEK-u, e ka

përpunuar atë dhe ua ka shitur bizneseve ose e ka eksportuar. Kontrata e kësaj ndërmarrje me KEK-un nuk është aktive. Punëtorët e saj janë pa të ardhura. Sot bizneset private detyrohen të importojnë qymyr nga jashtë. Së paku 6 milionë euro qymyr janë importuar vitin e kaluar. Qymyri është importuar edhe nga Serbia, me çmim prej 200 eurosh për ton, krahasuar me

60 euro për ton nga 'Kosova Thëngjilli', ka shkruar Hoti në "Facebook". Hoti ka shtuar disa pyetje për qeverinë Kurti: "Për kur po e ruajmë qymyrin? Çfarë strategjie është kjo? Pse duhet bizneset të blejnë qymyr tri herë më shtrenjtë nga Serbia e nga vendet e tjera? Pse të mos eksportohet qymyri kur tani ka kërkesë nga disa vende për shkak të krizës energjetike?"



“Skaz”-i i adoleshentëve



David LODGE

Plaka Sally nuk fliste shumë përveç kur shfrynte lidhur me Luntsët, sepse ishte e zënë duke përgjuar e duke u lazduar. Pastaj, krejt papritur, në anën tjetër të hollit, e pa një idiot që e njihnte. Një djalë me një palë aso kostume stofi gri të errët e me jelekë me katrorë. Tamam Ivy League. Punë e madhe. Ai rrinte afër murit, pinte duhan si i trentë dhe dukej i mërzitur për dreq. Plaka Sally tha: “E njoh atë djalë prej diku”. Kudo që shkonte ajo gjithmonë njihnte dikë ose mendonte se e njihnte. E përsëriste këtë pa pushim derisa u mërzi për dreq dhe ia ktheva: “Nëse e njeh, pse nuk afroresh t’ia japësh një puthje të madhe. Ish kënaq”. U prek kur i thashë kështu. Megjithatë, ai dikur e vuri re, u afrua dhe e përshëndeti. Ish dashtë ta shihje si u përshëndetën. Kishe menduar se nuk janë parë me njëri-tjetrin që njëzet vjet. Do të kujtoje se janë larë në të njëjtën vaskë ose diçka ngjashëm kur kanë qenë fëmijë. Miq të vjetër. E mundimshme. Pjesa më qesharake ishte se ata me siguri janë takuar vetëm një herë në ndonjë festë të shtirur. Në fund, kur mbaruan së jargavituni, plaka Sally na prezantoi. Emri i tij ishte George diçka – as që më kujtohet – dhe ndiqte Andoverin. Fort punë e madhe. Vetëm ta kishe parë kur plaka Sally e pyeti se a i pëlqeu shfaqja. Ishte tip shtinjaku që, kinse, duhej t’i jepte vetes hapësirë kur i përgjigjet pyetjes së dikujt. U tërhoq prapa dhe shkeli këmbën e zonjës pas tij. Me gjasë, ia theu çdo gisht në këmbë. Tha se shfaqja, në vetvete, s’ishte kryevepër, por që Luntsët ishin absolutisht engjëj. Engjëj. Pashë Zotin. Engjëj. Kjo më kalli. Pastaj

bashkë me plakën Sally filluan të flasin për njerëzit që i njihnin. Ishte biseda më e shtirur që e ke dëgjuar ndonjëherë në jetë.[1] J. D. SALINGER, *Rojë në thekërishte* (1951)

Skazi është fjalë tërheqëse ruse (sugjeron “xhazin” dhe “skatin”, si “skat-këndim”, për veshin anglez) që përdoret për të përcaktuar një lloj rrëfimi në vetën e parë dhe përmban karakteristikat e fjalës së folur e jo fjalës së shkruar. Në këtë lloj romani apo storje, narratori është personazh që i referohet vetes me “unë” dhe lexuesit i drejtohet me “ti”. Ai ose ajo përdor fjalor dhe sintaksë karakteristike të të folurit bisedor dhe duket sikur storjen e rrëfen në mënyrë spontane e jo si diçka të shkruar, të ndërtuar dhe të lëmuar me kujdes. Më shumë dëgjojmë sesa lexojmë, sikur e hasim ndonjë person të huaj llafazan në pub apo tren. Është e panevojshme të thuhet se ky është iluzion, produkt i një përpjekjeje të kalkularuar dhe rishkruar kujdesshëm nga autori “i vërtetë”. Stili narrativ që imiton besnikërisht të folurit real do të ishte praktikisht i pakuptueshëm, siç janë transkriptet e bisedave të regjistruara. Por është iluzion që krijon efekt të fuqishëm autenticiteti dhe sinjeriteti, të rrëfimit të së vërtetës.

Për romancierët amerikanë skaz-i ishte një metodë e kapshme për t’u çliruar nga tradita e trashëguar letrare angleze dhe evropiane. Shtysa kryesore u dha nga Mark Twain. “E gjithë letërsia moderne amerikane rrjedh nga një libër i Mark Twainit i quajtur *Huckleberry Finn*”, tha Ernest Hemingway – një mbivlerësim por, iluminues. Goditja mjeshtrërore e Twainit ishte në shkriren e stilit të gjuhës popullore

bisedore me një narratori të papjekur, një djalë adoleshent të mençur, vizioni i të cilit, për botën e të rriturve, përmbante freski dhe sinjeritet rrëmbyes. Për shembull, ky është reagimi i Huckut për llojet e ndryshme të besimit të krishterë: Nganjëherë vejusha më vinte me një anë dhe më fliste për Providencën ashtu sa më shkonte lëng prej goje por, mbase, të nesërmen zonjusha Watson me mënyrën e saj m’i rrëzonte prapë të gjitha. Kujtova se ekzistojnë dy Providenca dhe se një djali të shkretët mund t’i dilte mirë me Providencën e vejushës, por nëse zonjusha Watson e fshinte përpara, s’kishte më shpresë për të.

Holden Caulfieldi i J. D. Salingerit është pasardhës letrar i Huck Finnit: më i arsimuar dhe më i sofistikuar, bir i njujorkezëve të pasur por, ashtu si Hucku, është një i ri që ikën nga bota e hipokrizisë së të rriturve, korrupsioni dhe, nëse e përdorim fjalën e tij të pëlqyer, shtirja. Ajo që e tronditë Holdenin është gatishmëria e bashkëmoshatarëve të tij ta adoptojnë sjelljen korruptive të të rriturve. Në rrjedhën e storjes, Holdenie merr të dashurën në matinen e një shfaqjeje në Broadway ku luan çifti i famshëm i aktorëve, Alfred dhe Lynn Lunti. “Plaka Sally” dhe in johuri që, ndërkohë, i takon në hollë, përshkruhen në këtë fragment si aktrim krejtësisht joautentik i sjelljes shoqërore të të rriturve.

Elementet e stilit narrativ të Holdenit, që e bëjnë të tingëllojë si të folur e jo si shkrim dhe të folurit e adoleshenti, janë mjaft lehtë të identifikueshme. Aty kemi shumë përsëritje (sepse variacionet elegante të fjalorit kërkojnë mendim më të kujdesshëm) sidomos të shprehjeve zhargon si “trullan”, “u mërzi për dreq”, “shtirur”, “punë e madhe”, “më

kalli” dhe “plakë” (epitet që përdoret për gjithkënd të afërt pavarësisht prej moshës). Ashtu si shumë të rinj, Holdenie shpreh fuqinë e ndjenjave të tij me ekzagjerim, me anë të mjetit që retorët e quajnë hiperbolë: “pinte duhan si i trentë”, “do të kishte menduar se s’janë parë me njëri-tjetrin që njëzet vjet”, “jargavitej”. Sintaksa është e thjeshtë. Fjalitë zakonisht janë të shkurtra dhe të pakomplikuara. Shumë prej tyre nuk janë të formuara siç duhet, mungon folja e fundme (“Tamam Ivy League. Punë e madhe.”). Ka gabime gramatikore, siç bëjnë shpesh folësit (“Ishte tip shtinjaku që, kinse, duhej t’i jepte vetes hapësirë...”). Në fjalitë më të gjata klauzolat lidhen bashkë, siç i ndodh folësit, e nuk varen nga njëra-tjetra në struktura të ndërlikuara.

Informaliteti i diskursit të Holdenit është garanci e spontanitetit dhe autenticitetit të tij. Ajo ndihmohet nga biseda e mirëformuar, por pretencioze e Georgeit: “Tha se shfaqja, në vetvete, nuk ishte kryevepër, por që Luntsët ishin absolutisht engjëj”. Shprehja shkurtet edhe më tej dhe duket e stisur, jepet si ligjëratë e zhdrejtë ose e zhdrejtë e lirë në krahasim me shpërthimin e acaruar të Holdenit ndaj Sallyit, që citohet drejtpërsëdrejti: “Pse nuk afroresh me ia dhanë një puthje të madhe..”.

Them se stili i rrëfimit të Holdenit përshkruhet mjaft lehtë, por vështirë shpjegohet se si na e mban vëmendjen dhe na jep kënaqësi gjatë gjithë romanit. Sepse, mos të gabohemi, është stili ai që e bën interesant librin. Storja që tregohet është episodike, jopërfundimtare dhe kryesisht përbëhet nga ngjarje të parëndësishme. Megjithatë, sipas kritereve normale letrare, gjuha është shumë e

varfër. Salingeri, ventrilokuist i padukshëm që na flet përmes Holdenit, duhet të thotë gjithçka për jetën, vdekjen dhe vlerat themelore brenda kufijve të zhargonit të një njujorkezi shtatëmbëdhjetëvjeçar, duke iu shmangur metaforave poetike, ritmit të periudhave, shkrimin të bukur.

Një pjesë e përgjigjes ka të bëjë, padyshim, me humorin përqeshës të krijuar nga aplikimi i gjuhës “së ulët” të Holdenit ndaj shtirjeve të sjellshme të jetës shoqërore dhe kulturore, të shfaqura nga Sallyi dhe Georgei. Pasaktësia formale e anglishtes së tij është, gjithashtu, burim humorit – rreshti më qesharak në fragment është: “Me gjasë, ia theu çdo gisht në këmbë”, shtrembërim i shprehjes “çdo kockë në trup” që është edhe shprehje hiperbolike. Një arsye tjetër është se gjuha e Holdenit është edhe më nënkuptuese sesa që shprehet. Për shembull, në këtë fragment kemi, haptazi, temën e xhelozisë të Holdenit ndaj figurës mashkullore rivale të Georgeit, aq sa pretendohet se Holdenie përbuz rrobat e Ivy-Leagueit që i japin Georgeit status dhe sjellje të sofistikuar. Patosi i situatës së Holdenit ndaj Caulfieldit këtu, por edhe në tërë librin, është me efektiv meqë nuk shprehet me fjalë. Megjithatë, në analizën e fundit ka diçka çuditërisht poetike në këtë prozë, një manipulim delikat i ritmit të të folurit bisedor që e bën veprën të këndshme për t’u lexuar dhe rilexuar. Siç thonë muzikantët e xhazit, ajo vibron.

Përktheu nga anglishtja: Meli Krasniqi. T° drejtat e botimit Armagedoni .

[1] Përdorimi dialektor është i qëllimshëm.

E ardhmja e një Gjermanie të rrënuar

George ORWELL

Ndërsa përparimi në Gjermani vazhdon dhe del në pah gjithnjë e më shumë shkatërrimi i shkaktuar nga avionët bombardues aleatë, ka tre komente që gati çdo vëzhgues e gjen veten duke bërë. I pari është: "Njerëzit në shtëpi nuk e kanë idenë për këtë". I dyti, "Është një mrekulli që ata kanë vazhduar të luftojnë". Dhe i treti është, "Vetëm mendoni për punën e madhe që duhet për të rindërtuar gjithçka!"

Është mjaft e vërtetë që shkalla e goditjes së Gjermanisë nga aleatët nuk është realizuar e plotë as tani në këtë vend, dhe forca e saj në thyerjen e rezistencës gjermane është ndoshta shumë e nënvlerësuar. Është e vështirë t'i përditësosh raportet për luftën ajrore dhe njeriu i zakonshëm mund të falet nëse imagjnon se ajo që i kemi bërë Gjermanisë gjatë katër vjetëve të fundit është thjesht e njëjta gjë që na bënë në vitin 1940.

Por ky gabim, i cili duhet të jetë edhe më i zakonshëm në Shtetet e Bashkuara, ka në vetvete një rrezik potencial dhe protestat e shumta kundër bombardimeve pa dallim, që janë shqiptuar nga pacifistët dhe humanitarët, thjesht e kanë bërë më të ngatërruar çështjen. Bombardimi nuk është veçanërisht çnjerëzor. Lufta në vetvete është çnjerëzore dhe avioni bombardues, i cili përdoret

për ta paralizuar industrinë dhe transportin, është një armë relativisht e civilizuar. Lufta "normale" ose "legjitime" është po aq shkatërruese për objektet e pajetë dhe jashtëzakonisht shumë për jetët njerëzore. Për më tepër, një bombë vret një pjesë të rastësishme të popullsisë, ndërsa burrat e vrarë në betejë janë pikërisht ata që komuniteti mund të përballojë, më së paku të humbasë. Populli i Britanisë nuk është ndier kurrë i qetë për bombardimin e civilëve dhe pa dyshim se do të jetë po aq i gatshëm për t'i mëshiruar gjermanët sapo t'i mposhtin përfundimisht; por ajo që ata ende nuk e kanë kuptuar – falë imunitetit të tyre krahasues – është shkatërrimi i frikshëm i luftës moderne dhe periudha e gjatë e varfërimit që tani është përpara botës në tërësi.

Të ecësh nëpër qytetet e rrënuara të Gjermanisë do të thotë të ndiesh një dyshim të vërtetë për vazhdimësinë e qytetërimit. Duhet mbajtur mend se nuk është vetëm Gjermania ajo që është goditur. I njëjti shkretim shtrihet, gjithsesi, në pjesë të konsiderueshme, nga Brukseli në Stalingrad. Dhe aty ku ka pasur luftime tokësore, rrënimi është edhe më i madh. Në rreth 300 milje midis Marnës dhe Rinit, nuk ka një urë apo një rrugëkalim që nuk është hedhur në erë.

Edhe në Angli jemi të vetëdijshëm se na duhen tre milionë shtëpi



dhe se shanset për t'i marrë ato brenda një kohe të matshme duken mjaft të vogla. Por sa shtëpi do t'i duhen Gjermanisë, Polonisë, BRSS, apo Italisë? Kur dikush mendon për detyrën e jashtëzakonshme të rindërtimit të qindra qyteteve evropiane, kupton se duhet të kalojë një periudhë e gjatë para se të rivedosen edhe standardet e jetesës të vitit 1939.

Ne nuk e dimë ende masën e plotë të dëmit që i është bërë Gjermanisë, por duke gjykuar nga zonat që janë pushtuar deri më

tani, është e vështirë të besohet në fuqinë e gjermanëve për të paguar ndonjë lloj dëmshpërblimi, qoftë në mallra apo me punë. Thjesht për ta ristruar popullin gjerman, për t'i vënë në punë fabrikat e shkatërruara dhe për ta penguar bujqësinë gjermane të bjerë në kolaps pasi punëtorët e huaj të jenë çliruar, do ta harxhojë të gjithë fuqinë punëtore që gjermanët ka të ngjarë ta kenë.

Nëse, siç është planifikuar, miliona prej tyre do të dëbohen për punë rindërtimi, vetë rimëkëmbja e Gjermanisë do të jetë edhe më e

ngadaltë. Pas luftës së fundit më në fund u kuptua pamundësia për të marrë dëmshpërblime thelbësore parash, por në përgjithësi u kuptua më pak se varfërimi i një vendi të vetëm ndikon në mënyrë të pafavorshme te bota në tërësi. Nuk do të krijonte asnjë përparësi nëse Gjermania do të kthehej në një lloj lagjeje të varfër rurale.

8 prill 1945

Përktheu nga anglishtja: Gran Zela. T° drejtat e botimit

Shkolla shqipe u hap me lejen e Stambollit dhe me mbështetjen e zyrtarëve osmanë në Korçë

Nga: Mësuesi Naum DHIMITËR Naçi, i njohur më shumë si Nuçi NAÇI (Revista Ditur mars 1927)

Nga vitin 1877 gjer 1885 çështja kombiare morri shpirt e trup, edhe shoqëria që u-filluan në Stamboll, në Bukuresht, zun' e shtypnin libra e gazeta në gjuhën amtare.

Në gjithë qytetet e mëdhenj të Shqipërisë u-dërguan fitime me këshilla që të kërkojnë mësonjetore për të kënduar vegjëlja gjuhën shqipe.

Shqiptarët që kishin themeluar shoqërinë shqiptare në Stamboll arritën të marrin nga Ministri e Arësimit të Turqisë leje për të çelur shkollë private në gjuhën shqipe, në Korçë.

Leja u dha mbi emërin e te ndjerit Pandeli Sotiri nga Selckë e Përmetit. Shoqëria e Bukureshtit "Drita" u-muarr vesh me atë të Stambollit që, më parë të përdomin masa të buta me njerëzit që atëherë kishin ndjenja të tjera, si edhe me kryetar e kishës, Dhespotët e atëhershëm, që të viret gjuha shqipe ne shkollat që sundoheshin prej Patrikanës.

Për këtë qëllim u dërgua nga Bukureshti anëtar i shoqërisë i ndjeri Thimi Marko, që të fjalosesh

me burrat që ishin në Stamboll. Thimi Markua ardhni në Korçë më 1885, ne verë, edhe u paraqit në mbledhjen e Mitropolisë, u tregoj dëshirën e gjithë Korçarëvet të Bukureshtit, si edhe një letër nga Anastas Lakçe, në të cilën Lakçeja i thosh Dhimogjendisë se, interesi e doq që të futej gjuha shqipe në shkollat e komunitetit të Korçës, që të mesonej nga çunat e vajzat. Këshilla bashkë me Dhespotin e asaj kohe (Fillotheos) së pari thanë se munt të bëhej pun' e tillë, por me pas thanë se duhej leje nga Patriku. Leja u kërkua, po përgjigjeja ishte që nuk mundesh të pranohej në shkollat e komunitetit të Korçës një gjë e tillë, masi nuk rrithte nga dëshirë e popullit, por nga disa njerëz të blerë prej propagandës Austriake, e nga disa Protestanë!

Kjo gjë shkaktoi grindje midis këshillit dhe anëtarit i saj Jovan Kosturi, u largua nga mbledhja. Si u-vërtetuan atdhetarët se me anë të Mitropolisë s'behej as gjë e dobishme, atëhere dërguan edhe thërriten Pandeli Sotirin, qe akoma s'ishite nisur nga Stambolli. Në mbarim të vitit 1885 çeli shkollën të parë shqipe për djem e vajza ne Korçë. Mytesarrif i Korçës atë kohë ishte Mahmud Pashë Elbasani, i cili e përkrahu idenë kombëtare.



Ndërtesa e vëllazërisë Kristaq Terpo – që sot është shkollë Normale e vajzave – në pllata të Shëngjergjit, u-çel për shkollë. Këtë ndërtesë ashtu si është edhe sot, e përmendure vëllazëri e pati blerë prej komunitetit orthodoks disa vjet më parë, dhe komuniteti e kish marë për shkak borxhi nga Drenovari Kunxho. Asi kohe kjo godin u-ble për 480 lira turke; sot vlefta e saj arin gjern 3,000 napolona dhe është e falur nga e

përmendura vëllazëri që të përdoret për shkollë.

Aty nisë të nepëshin të parat ditë mësimet e gjuhës shqipe nga Pandeli Sotiri; për vitin shkollor 1885-1886 pati ndihmës z. Thanas Sina nga Postenani i Leskovikut, edhe për gjuhën turqishte avukat Ibrahim Efendinë.

Si ky vit i fillimit ashtu edhe viti 1886-1887 pati nxënës, çupa e djem, afëro 200.

Intrigat e Mitropolisë dhe

Patrikanës shtrënguanë Pandeli Sotirë të hiqet, pa ardhur funt i vitit 1887.

Pandeli Sotiri kishte grua greke nga Fanari; ajo e shgrëngoiti të largoneshe së këtejmi. Shkolla mbeti në duart e z. Thanas Sinës. Pandeliu u-hoq në Stamboll ku, pas ca kohësh, gjeti vdekjen të tmeruar: E kishin flakur nga penxheret e shtëpisë ku rinte, tre katesh; thonë se këtë vdekje të tmeruarë j'i përgatiti e shoqja edhe i vjehri.

Çfarë ndodh kur Inteligjenca Artificiale lexon gjithçka?



Nga Ross ANDERSEN

Inteligjenca Artificiale (AI) është treguar vitet e fundit si një makineri studimi shumë e shpejtë, edhe po edukohet në një mënyrë të tillë që do të turpëronte edhe studiuesit më të aftë. Të mbyllur për muaj të tërë në bibliotekat borgesiane, pa asnjë ndërprerje, Inteligjenca Artificiale urdhërohet të mësohet gjithçka mbi kulturën njerëzore. Dhe kur AI dalin nga këto sesione studimi, ato zotërojnë aftësi të reja mahnitëse. Edhe njerëzit me mendjet më të zhdërvjellëta nga ana gjuhësore – hiperpoliglotët – do të mbeten prapa. Sepse tani Inteligjenca Artificiale mund të përkthejë në kohë reale në më shumë se 100 gjuhë. Ajo mund të krijojë shkrime me një sërë stilesht letrare dhe të shkruajë poezi të pranueshme me rimë. Platformat “Ithaca” dhe “DeepMind”, mund të analizojnë shkronjat greke të gdhendura në mermer dhe të hamendësojë tekstin që ka qenë shkruar dhe që është shkatërruar nga vandalët mijëra vjet më parë. Këto suksese sugjerojnë një rrugë premtuese përpara për zhvillimin e AI: Mjafton që të futni në të sasi gjithnjë e më të mëdha teksti të krijuar nga njeriu dhe të prisni që të shfaqen aftësitë e reja të mrekullueshme. Me të dhënat të mjaftueshme, kjo qasje mund të gjenerojë një inteligjencë më të rrjedhshme, apo një mendje njerëzore artificiale, e ngjashme me ato që parashikojnë thaujse të

githa mitologjitë tona të së ardhmes. Problemi është, se ashtu si produktet e tjera kulturore njerëzore të nivelit të lartë, proza e nivelit të lartë renditet ndër gjërat më të vështira për t’u prodhuar. Sepse ajo nuk është e disponueshme me shumicë, dhe për AI, asnjë tekst i vjetër nuk do të funksionojë: Modelet e dimensioneve të mëdha të aplikuara për libra janë shkrimtarë shumë më të mirë se ata që janë stërvitur duke bërë postime të pafundme në mediat sociale. (Në këtë kontekst, është më mirë të mos mendosh për zakonet e dikujt në Twitter.) Kur llogarisim se sa fjali të mirë – ndërtuara mbeten që AI të gëlltisë, numrat nuk janë inkurajues. Një ekip studiuesish të udhëhequr nga Pablo Villalobos në “Epoch AI” parashikoi kohët e fundit se programe si ChatGPT do të arrijnë të shkruajnë materiale me cilësi të lartë brenda vitit 2027. Por pa një tekst të ri për t’u trajnuar, brezi i AI mund të pësojë një fund të parakohshëm. Këtu vlen të theksohet se vetëm një pjesë e vogël e krijimtarisë së përgjithshme gjuhësore të njerëzimit është në dispozicion për t’u lexuar. Kanë kaluar më shumë se 100.000 vjet që kur afrikanët krijuan, e tejkaluan fazën e britmave emocionale të paraardhësve tanë kafshë, duke nisur t’i përkthejnë mendimet e tyre në sisteme të gjera tingujsh. Çdo koncept i shprehur në ato protogjuhë – dhe shumë gjuhë që pasuan – ka të ngjarë të humbasë

përgjithmonë, megjithëse unë kënaqem kur e imagjinoj se disa nga fjalët e tyre janë ende me ne. Tek e fundit, disa fjalë angleze kanë një orgjinë të lashtë: flow, mother, fire dhe ash (rrjedha, nënë, zjarr, hi) kanë ardhur tek në nga popujt e Epokës së Akullit. Shkrimi i ka dhënë mundësi qenieve njerëzore të kapin dhe ruajnë shumë më tepër nga fjalët tona. Por ashtu si shumica e teknologjive të reja, në fillim shkrimi ishte i kushtueshëm, dhe kjo është arsyeja pse fillimisht u përdor kryesisht për mbajtjen e llogarive ekonomike. Sepse kërkohej kohë për të pjekur dhe lagur argjilën për të shkruar më pas mbi të, për të prerë papirusin në shirita të përshtatshëm për t’u lidhur me rretet, për të strehuar dhe ushqyer murgjit që kopjonin tekste të ndryshme etj. Këto teknika që kërkonin shumë burime, mund të ruanin vetëm një mostër të vogël të prodhimit kulturor të njerëzimit. Derisa shtypshkronja filluan të botojnë libra në masë, një shenjë se kujtesa jonë kolektive tekstuale arriti një shkallë industriale. Studiuesit në Google Books vlerësojnë se që nga koha e Gutenberg, njerëzit kanë botuar më shumë se 125 milionë tituj librash, duke mbledhur ligje, poema, mite, ese, histori, traktate dhe romane. Ekipi “Epoch” vlerëson se 10-30 milion prej këtyre librave janë dixhitalizuar tashmë, duke i dhënë mundësi AI-së të lexojë qindra miliona në mos edhe më shumë se 1 trilion fjalë. Këto shifra mund të

duken mbresëlënëse, por janë brenda normës së 500 miliardë fjalëve që trajnuan modelin që mbështet funksionimin e ChatGPT. Pasardhësi i tij, GPT-4, mund të stërvitet të mësojë dhjetëra trilion fjalë. Ka zëra se kur GPT-4 të nisë punën brenda këtij viti, do të jetë në gjendje të gjenerojë një roman me 60.000 fjalë vetëm me një kërkesë. Dhjetë trilion fjalë janë të mjaftueshme për të përfshirë në të të gjithë librat e dixhitalizuar të njerëzimit, të gjitha punimet tona shkencore të dixhitalizuara dhe pjesën më të madhe të blogosferës. Kjo nuk do të thotë se GPT-4 do ta ketë lexuar të gjithë atë material, vetëm se realizimi i kësaj është brenda mundësive të tij teknike. Por vetëm sepse AI do të jetë në gjendje shumë shpejt të lexojë të gjithë librat tanë, nuk do të thotë se mund të arrijnë të analizojë të gjithë tekstet që prodhojmë. Kapaciteti i ruajtjes i internetit, është i një rendi krejtësisht të ndryshëm dhe është një teknologji shumë më demokratike e ruajtjes së kulturës sesa botimi i librave. Çdo vit, miliarda njerëz shkruajnë fjali që janë të grumbulluara në bazat e të dhënave të saj, me shumicën të zotëruara nga platformat e mediave sociale. Në përgjithësi, teksti i rastësishëm i marrë nga interneti nuk krijon të dhëna të mira trajnimi. Artikujt e Wikipedia-s janë një përjashtim i dukshëm. Por ndoshta algoritmet e ardhshme do ta lejojnë AI-të do të arrijnë të dekodojnë kuptimin e postimeve tona në Twitter,

Instagram dhe statuset në Facebook. Por këto burime me cilësi të ulët nuk do të jenë të pashtershme. Sipas Villalobos, brenda pak dekadash, inteligjenca artificiale e leximit të shpejtë, do të jetë mjaft e fuqishme për të përvetësuar qindra trilion fjalë, duke përfshirë të gjitha ato që qeniet njerëzore ka futur deri më sot në rret. AI mund të njohë fytyrën tuaj pas një maske apo të dallojë tumore që janë të padukshme për syrin e radiologut. Po ashtu, inteligjenca artificiale e trajnuar me fotot specifike ka nisur të zhvillojë një imagjinatë vizuale. DALL-E 2 i OpenAI u trajnuar mbi 650 milionë imazhe, secila e çiftuar me një tekst të shkurtër. DALL-E 2 ka parë gjurmët e dorës që kanë lënë njerëzit e Epokës Paleolitit. Ai mund të imitojë stilet e ndryshme të penelit të mjeshtrave të Rilindjes. Mund të krijojë makro- foto realiste të hibrideve të çuditshme të kafshëve. Sidoqoftë, nëse inteligjenca artificiale jonë e mbushur me të dhëna do t’ia kalojë një ditë njohjes njerëzore, neve do të na duhet ta ngushëlojmë veten me faktin se ato janë krijuar sipas imazhit tonë. Ai nuk janë alienë. Ata nuk janë tjetri ekzotik. Ata janë një pjesë prej nesh dhe janë nga këtu. Ata kanë vështruar peizazhet e Tokës. Kanë parë miliarda herë Diellin duke perënduar. I dinë historitë tona më të vjetra. Përdorin emrat tanë për yjet. Ndër fjalët e para që mësojnë janë rrjedhë, nënë, zjarr dhe hi. / Marr me shkurtime nga [The Atlantic](#)

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Envert
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Dy derbit e Superligës përfundojnë pa fitues

Ndeshjet Ballkani - Drita dhe Gjilani - Prishtina kanë përfunduar pa baras, duke bërë që të mos ketë ndryshime në renditjen tabelore të Superligës së Kosovës në futboll



EPOKA E RE **Veton ZYMBERI**

Prishtinë, 9 mars - Dy ndeshjet derbi të javës së 24-t në Superligë kanë përfunduar pa fitues. Ballkani dhe Drita luajtën baras me rezultat 1-1. Skuadra nga Suhareka ishte e para që kaloi në epërsi, kur kapiteni Edvin Kuç në minutën e 17 realizoi me kokë për 1-0. Mysafirët nuk u dorëzuan dhe barazuan rezultatin në minutën e 36. Autor i golit ishte Leonat Vitija. Në pjesën e dytë gola nuk pati dhe skuadrat i ndanë pikët. Ballkani vazhdon të jetë në pozitën e parë me dy pikë më shumë se Drita që është e dyta. Në derbin për pozitën e tretë që dërgon në Evropë në mes të Gjilanit dhe Prishtinës nuk pati fitues (0-0), ani pse rastet nuk munguan nga të dyja skuadrat. Gjilani renditet në pozitën e tretë me 39 pikë, kurse kryeqytetasit në pozitën e katërt me

32 pikë. Të mërkurën janë zhvilluar tri ndeshje të javës së 24-t në Albi Mall Superligën e Kosovës. Skuadra e Ferizajt ka shënuar një fitore të madhe në përballje me skuadrën e Llapit (2-1). Mysafirët kaluan të parët në epërsi me golin e Gerhard Prognit në minutën e 11, por kjo nuk i ndali futbollistët e Ferizajt që ta kërkojnë përmbysjen e rezultatit që e arritën në këtë ndeshje. Në minutën e fundit të pjesës së parë, Edon Sadriu realizoi një gol të bukur për t'i barazuar shifrat në 1-1. Edon Sadriu ishte hero i vendësve, kur në minutën e 59 shënoi pas një asistimi të bukur nga Betim Haxhimusa për rezultatin final 2-1. Fitore të madhe ka realizuar edhe Dukagjini që ka mposhtur në udhëtim Malishevën me rezultat 1-2. Tri pikë në udhëtim i ka arktuar edhe Trepça '89 që ka mposhtur Drenicën me rikthim 1-2.

SUPERLIGA - Java 24

Ballkani - Drita	1-1
Gjilani - Prishtina	0-0
Malisheva - Dukagjini	1-2
Drenica - Trepça '89	1-2
Ferizaj - Llapi	2-1

Tabela

	Pikë
1. Ballkani	50
2. Drita	48
3. Gjilani	39
4. Prishtina	32
5. Dukagjini	29
6. Llapi	29
7. Trepça '89	26
8. Malisheva	25
9. Ferizaj	24
10. Drenica	23

SHKURT

Xhaka: Arteta na e ka ndryshuar edhe ushqimin

Granit Xhaka ka treguar se si trajneri Mikel Arteta e ka kthyer skuadrën në pretendente për titull në Premierligë. Fitorja e së shtunës ndaj Bournemouthit ishte po aq dramatike. Gjithçka u përmbys në sekondat e fundit të ndeshjes me Arsenalin që fitoi me rezultat 3-2 edhe pse ishte duke humbur 2-0. "Dua të them, talenti nuk mjafton. Vetëm me talent nuk mund të arrish diçka të madhe. Nëse na shihni në fushë stërvitore, ditë pas dite, sa shumë kujdesemi, sa shumë punojmë, çdo gjë fillon diku. Mikel ndryshoi edhe ushqimin tonë. Ai ndryshoi shumë ushqime. Yndyra e trupit tonë ra në masë të madhe. Janë detaje të vogla, por masive, por me ndikim të madh", ka thënë Xhaka.

Kosova renditet e pesta në botë në Paraglajd

Fanol Shala ka njoftuar për një sukses madhor të tij në sportin e Paraglajdit. Ai ka thënë se është renditur në vendin e 9 në renditjen botërore. Shala, po ashtu, theksoi se Kosova si shtet është renditur në vendin e pestë. "Pas publikimit të pikëve nga FAI, e rifreskuar më 1 mars 2023, renditimi në vendin e 9 (nëntë) në Botë dhe si shtet Kosova, vendi që unë përfaqësoj me shumë krenari, renditet në vendin e 5 në botë", ka thënë Shala.

Federata Botërore e Aeronautikës i ka publikuar rezultatet më 1 mars. Fanol Shala ka qenë pjesë e ekipit të Shoqatës së Kërkim-Shpëtimit nga Kosova, që ka marrë pjesë në operacionet e shpëtimit pas tërmetit në Turqi.

Legjenda e PSG-së: Messi zhduket në ndeshjet e mëdha

Ish-lojtari i PSG-së, Jerome Rothen, akuzon hapur Lionel Messin për eliminimin e Paris Saint-Germain në Ligën e Kampioneve. Ai ka thënë se Messi zhduket në ndeshjet e mëdha. "Nuk e duam atë. Messi nuk është i përfshirë në klubin tonë. Ne i kemi parë ndeshjet e tij në Kupën e Botës, sa i frymëzuar ishte. Ne kemi nevojë për respekt të Messit ndaj klubit të kryeqytetit, i cili e lejon ta ketë atë rrogë. Vetëm PSG-ja mund t'ia jepte atë rrogë. Klubi gaboi shumë, sepse mendonte se Messi do të fitonte Ligën e Kampioneve. Një vit më parë, kundër Real Madridit, ai u zhduk në fushë dhe të gjithë u ankuan se gaboi Donnarumma. Në fakt, ai nuk bëri asgjë", ka thënë Rothen.

Përcaktohen skuadrat e Final 4 në Ligën Unike

PRISHTINË, 9 MARS - Dy ndeshjet e fundit të javës së dhjetë kanë përcaktuar renditjen përfundimtare të Ligës Unike të Femrave.

Bashkimi siguroi vendin e parë me shtatë fitore e tri humbje, ndërsa Tirana përfundoi garat me tri fitore e shtatë humbje. Samra

Omerbasiq ishte më e mira te Flamurtari me 23 pikë e 12 kërcime, ndërsa Ornella Lalaj dhe Jomra Matthis shënuan nga 20 pikë për Partizanin.

Në Final 4 që do të zhvillohet në Vlorë më 15/16 mars do të ndeshen Bashkimi me Partizanin dhe Flamurtari me Prishtinën.



Mercedesi ngre 'flamurin e bardhë': Red Bull do t'i fitojë të gjitha garat

STUTTGART, 9 MARS - Shefi i Mercedesit, Toto Wolff, duket se është dorëzuar që në fillim të këtij sezoni të Formulës 1 për sa i përket garës për titull. Jo vetëm kaq, por ai beson se Red Bulli do të dominojë edhe këtë vit, ashtu sikurse pati

dominuar Mercedesi për vite me radhë. "Pas asaj që pamë në garën e parë në Bahrein, mendoj se këtë vit Red Bull do t'i fitojë të gjitha garat. Kur erdha në Bahrein kisha shumë shpresa dhe isha optimist. Por, pasi e pamë garën, largohem pesimist,

pasi diferenca me Red Bullin janë shumë të mëdha", ka thënë Toto Wolff. "Ata mund të bëjnë çfarë të duan këtë sezon, të luajnë me konkurrencën, ndërkohë që gomat nuk degradohen siç ndodh me makinat e tjera. Ky është realiteti dhe

duhet ta pranojmë atë, duke u përpjekur të gjejmë ndonjë zgjidhje. Vjet makina jonë u përmirësua dhe fituam një garë, ndaj vendosëm të mbajmë këtë koncept edhe këtë sezon, por duket se kjo gjë nuk do të funksionojë. Këtë vit nuk besoj se do të



duelojmë për titullin apo për të fituar ndonjë garë", u shpreh shefi i Mercedesit.

Kosova pëson humbje nga Bosnjë-Hercegovina

PRISHTINË, 9 MARS - Në praninë e rreth 2 000 shikuesve, në një ambient të bukur sportiv, Përfaqësuesja e Kosovës në hendboll është përballur me Bosnjë-Hercegovinën. Mysafirët nga Bosnja kanë fituar me rezultat 25:22. Ndeshja u luajt në Pallatin e Rinisë në Prishtinë. Ndeshja ishte e fortë dhe e hapur thuajse deri në fund, por cilësia, sidomos përvoja në nivel të lartë e lojtarëve të Bosnjës, ka bërë dallimin. Lojtarët tanë kanë dhënë maksimumin e në raste edhe janë djegur nga dëshira e madhe për sukses. Angazhimi nuk ka munguar nga fillimi e deri në fund, por që këtë herë nuk mjaftoi. Mysafirët nga Bosnja e kanë nisur më mirë ndeshjen duke krijuar epërsi deri në shtatë gola në pjesën e parë. "Dardanët", megjithatë, u kthyen në lojë dhe afruan rezultatit në 14:10, me të cilin përfundoi pjesa e parë.

Pjesa e dytë nisi shumë mirë për Kombëtaren tonë. Sulmet ishin më efikase e mbrojtja më e fortë. Në minutën e 40 barazuam



rezultatit në 16:16 e më pas kaluan në epërsi 17:16. Golin e epërsisë e shënoi Egzon Gjuka në minutën e 42-të. Por më pas Kosova pati krizë në lojë, kryesisht për meritë të nivelit të kundërshtarit. Bosnja u shkëput në 23:17 dhe më pas ia doli ta mbajë epërsinë deri në fund. Drenit Tahirukaj ishte më efikas te "dardanët" me 5 gola. Nga 4 i shënuan Drilon Tahirukaj e

Egzon Gjuka. Haris Berisha i kishte pesë pritje, kurse Flamur Gërbeshi tri. Kosova tani i kthehet ndeshjes në udhëtim me Bosnjë-Hercegovinën. Ndeshja luhet në Tuzla të dielën. Për ta përkrahur nga afër kombëtaren tonë, në palestër ishte kryeministri Albin Kurti, ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Hajrulla Çeku dhe zëvendësministria Daulina Osmani.

Ditë zhgënjyese për Dallasin dhe Denverin, triumfojnë Bostoni e Phoenixi

BOSTON, 9 MARS - Bostoni fitoi me rezultat 115-93 ndaj Portlandit, duke mbajtur të gjalla shpresat për kreun e renditjes në Lindje. Tatum me 30 pikë bëri dallimin në fushë për Celticsin, duke i bërë të pavlefshme 27 pikët e Lillardit për Portlandin. Humbet ekipi i Miamit, që në fushën e tij u mund me rezultat 104-100 nga Clevelandi (Garland 25 pikë). Zhgënjëu skuadra e Dallasit, që u mund me rezultat 113-106 nga



New Orleansin, në një ndeshje të dominuar nga vendasit. Irvingu realizoi 27 pikë për Dallasin, por që s'mjaftuan për fitore, ndërsa për vendasit u dallua McCollum me 32 pikë. Clippersat, falë 24 pikëve të Leonardos e 23 të Georges, mposhtën me rezultat 108-100 Toronton. Ngjit shkallët në renditje

në Perëndim ekipi i Phoenixit, që fitoi me rezultat 132-101 ndaj Oklahomas. Devin Booker me 44 pikë bëri diferencën në fushë për Suns. Humbet edhe Denveri, ekipi që kryeson renditjen në Perëndim, që në fushën e tij u mund 117-96 nga Chicago (u dallua Zach LaVine me 29 pikë).

REZULTATET

Washington - Atlanta	120-122
Boston - Portland	115-93
Miami - Cleveland	100-104
New Orleans - Dallas	113-106
Denver - Chicago	96-117
Phoenix - Oklahoma	132-101
Clippers - Toronto	108-100

Pioli: Kualifikim i merituar, tash presim shortin

Trajneri i Milanit, Stefano Pioli, ka thënë se kualifikimi i skuadrës kuqezi ishte plotësisht i merituar për në

çerekfinalen e Ligës së Kampionëve, pas barazimit pa gola ndaj Tottenhamit. "Ne bëmë mirë. Ne i kërkuam skuadrës të luante me

karakter dhe ne mund të kishim më shumë posedim në pjesën e parë, për të qenë i sigurtë. Nuk e lëshuam kurrë. Është një kualifikim

plotësisht i merituar duke marrë parasysh mënyrën se si luajtëm në të dyja ndeshjet. Duhet ta bëjmë hap pas hapi. Ishte i rëndësishëm, para së

g gjithash, kalimi i fazës së grupeve, një përmirësim nga sezoni i kaluar. Tani presim shortin dhe të shohim se çfarë do të ndodhë", ka thënë Pioli.

SHKURT

Mbappe: Ishte maksimumi ynë

Paris Saint-Germainit u eliminua nga Liga e Kampionëve pasi pësoi humbje edhe në ndeshjen e dytë nga Bayern Muncheni (2-0). Kylian Mbappe është shprehur i zhgënjyer me këtë eliminim, derisa ka thënë se ky ishte maksimumi i skuadrës franceze në garën më të fortë të futbollit në botë. "Një tjetër zhgënjim. Kemi humbur nga një skuadër e madhe dhe tash na mbetet kampionati. Shpresojmë ta fitojmë titullin. Bayerni e ka një skuadër të ndërtuar për ta fituar Ligën e Kampionëve, derisa për ne ky ishte maksimumi", ka thënë Mbappe. "Nëse do ta rikonsideroj të ardhmen time? Jo, jo... jam i qetë, e vetmja gjë që çon peshë për mua në këtë sezon është që ta fitojmë kampionatin dhe më pas të shohim. Jemi të dëshpëruar dhe të mërzitur, por duhet ta ndërrojmë faqen, duhet të mendojmë për gjëra të tjera", ka shtuar Mbappe.

Nagelsmanni: E merituar fitoren ndaj PSG-së

Trajneri Julian Nagelsmann ka thënë se Bayern Muncheni e mposhti me meritë PSG-në (2-0). Klubi gjerman fillimisht e fituar ndeshjen e parë në Paris me rezultat minimal 0-1, ndërsa në ndeshjen kthyesë në Gjermani shënoi fitore 2-0 dhe u kualifikua në çerekfinale të Ligës së Kampionëve. "Në pjesën e parë nuk bëmë shumë mirë, lejuam më shumë hapësira sesa e kishim menduar. Në të dytën më pas u mbrojtëm mirë dhe ishim të rrezikshëm me topin në këmbë. Në fund besoj se e merituar fitoren", ka thënë Nagelsmann.

Conte: Duhet të punojmë më shumë

Tottenham Hotspuri është eliminuar nga Liga e Kampionëve, pasi luajti baras me Milanon (0-0), derisa në ndeshjen e parë në "San Siro" kishte humbur me rezultat 1-0. Trajneri Antonio Conte ka thënë se "Spurs"-i duhet të punojë më shumë për të pasur sukses. "Ky është një ekip që sigurisht duhet të punojë shumë për t'u bërë konkurrues në nivele të rëndësishme. Për mendimin tim, ende kemi një rrugë të gjatë për të bërë. Unë jam këtu që 14 muaj dhe të mos të harrojmë se vitin e kaluar ne ishim jashtë Ligës së Konferencave nga faza e grupeve. Mendoj se kemi bërë një hap duke u kualifikuar në Ligën e Kampionëve. Luajtëm kundër kampionëve të Italisë, por nuk fituam asgjë. Ne duhet të punojmë më shumë", ka thënë Conte.

Chelsea i shtohet garës për De Jongun

Mesfushori i Barcelonës, Frenkie De Jong, pëlqehet shumë nga Manchester Unitedi, por garës për transferimin e tij i ka hyrë edhe skuadra e Chelseat. Mediet në Spanjë kanë raportuar se skuadra londineze është e gatshme të paguajë plot 80 milionë euro për kartonin e mesfushorit holandez. De Jong nuk është një titullar fiks në formacionin e trajnerit Xavi Hernandez dhe Barcelona mund ta pranojë shitjen e tij për një shumë të tillë dhe të njëjtat t'i përdorë për përforcime në afatin kalimtar të verës.



Kompania Rajonale e Ujësjesit
"Mitrovica" SH.A.
"Rr.Liqeni", p.n. 40000 Mitrovicë-Suhodoll



Konform me funksionet dhe kompetencat që parashihen Nenit 21, lidhur me nenin 17 të Ligjit për Ndërmarrje Publike (Ligji Nr. 03/L-087), i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe Ligjin nr. 05/L-009 për Ndërmarrjet Publike, Bordi i Drejtorëve dhe Komisioni i Auditimit të KRU "Mitrovica" Sh.A., me seli në Mitrovicë-Suhodoll, në mbledhjen e mbajtur me datë 02.03.2023, vendosi të shpall këtë:

KONKURS PUBLIK

Titulli i punës : Zyrtar Kryesor Financiar

Vendi: Mitrovicë-Suhodoll

Ndërmarrja: Kompania Rajonale Ujësjesit, Mitrovica, Sh.A.

I përgjigjet: Bordit të Drejtorëve dhe Kryeshefit Ekzekutiv të KRU "Mitrovica" Sh. A, Mitrovicë

Mandati: 3 vite- me mundësi vazhdimi

Kushtet dhe kualifikimet e kërkuara:

Bordi i Drejtorëve dëshiron të sigurohet që të gjithë kandidatët potencial të jenë persona me integritet të njohur të cilët i plotësojnë kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1, i plotësojnë kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.2, pikat (d), (f), (k) dhe (l) dhe kanë përvojën e nevojshme profesionale dhe shkollimin e kërkuar për pozitën në fjalë.

Përveç këtyre kushteve të përgjithshme kandidatët duhet të plotësojnë edhe këto kushte të veçanta:

- Të ketë diplomë universitare Master të Fakultetit Ekonomik ose ekuivalente dhe përvojë të konsiderueshme nga fusha e financave dhe/ose kontabilitetit.
- Diplomat nga universitetet e huaja duhet të jenë të nostrifikuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë;
- Të ketë së paku 5 vjet përvojë punë në menaxhim të dëshmuar në financa dhe/ose kontabilitetit;
- Të ketë integritet të lartë moral e profesional,
- Të ketë aftësi të dëshmuara në menaxhim,
- Njohja e gjuhëve të huaja është përparësi,
- Të mos jetë i dënuar ose nën hetime,
- Njohurit në interpretimin e Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK) dhe të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), sipas udhëzimeve të Federatës ndërkombëtare të Kontabilistëve (FNK) do të jenë përparësi;

Funksioni dhe përgjegjësitë kryesore të Zyrtarit Kryesor Financiar të përcaktuara me Statutin e kompanisë:

Zyrtari Kryesor Financiar i Shoqërisë ("ZKF") do të menaxhoj, nën drejtimin dhe mbikëqyrjen e KE, çështjet financiare të Shoqërisë, varësisht prej kufizimeve të vëna nga Këshilli i Drejtorëve- do të ketë autoritetin e lidhjes së të gjitha kontratave financiare për Shoqërinë, dhe do të jetë përgjegjës që:

Të mirëmbajë llogaritë e Shoqërisë të azhuruara dhe të sakta;

Të themeloj dhe udhëheq të gjitha kontrollet e brendshme financiare, duke përfshirë blerjet, pranimet e parave të gatshme, dhe pasuritë themelore. Të monitoroj llogaritë e pagueshme dhe të koordinojë pagesën e faturave dhe blerjet speciale. Të rishikoj shpenzimet e të punësuarve për të siguruar pajtueshmërinë me politikat e Shoqërisë dhe buxhetin para pagesës së tyre;

Të përgatisë të dhënat e Shoqërisë për auditim në fund të vitit;

Të rishikoj, të arrij marrëveshje për prokurime dhe mirëmbajtje të të gjitha bizneseve të ndërlidhura me politikat e sigurimit;

Të koordinojë funksionet tjera të biznesit, siç janë dhënia me qira e objekteve dhe pajisjeve, si dhe të bëj blerje me KE dhe zyrën apo funksionin e prokurimit të Shoqërisë;

Menaxhoj thesarin e Shoqërisë;

Të vendos dhe përgatitë buxhetet; dhe

Çfarëdo tjetër detyre e përcaktuar nga ana e KE.

Detyrat dhe përgjegjësitë e ZKF-së janë:

- Përgjigjet për të gjitha veprimet financiare të kompanisë në regjionin që e mbulon kompania.
- Obligohet për bashkëpunim të ngushtë me: Bordin e Drejtorëve dhe Komisioni i Auditimit, Kryeshefin Ekzekutiv, Drejtorin Komercial, Drejtorin Teknik dhe Menaxherët e Departamenteve,
- Ka për detyrë të nxjerr dhe planifikoj buxhetin, të vëzhgojë mospërputhjet. Të përcjellë regjistrimin në kontabilitet, të japë këshilla të gjithë personelit të sektorëve për veprime efektive. Të vëzhgojë-përcjell qarkullimin e parasë se gatshme dhe transaksionet bankare,
- Përmes Menaxherit Ekzekutiv dhe personelit tjetër, të udhëheqë me ndërmarrjen përpara palëve të interesit (Bordi i Drejtorëve-Aksionari, Komuna, Donatorët). Të sigurojë llogari sipas nevojës që kërkohen për raportimin e ndërmarrjes,
- Përmes personelit nënrenditës, posaçërisht menaxherit ekzekutiv të shitjes, dhe në bashkëpunim të ngushtë me menaxherin ekzekutiv të shërbimit të konsumatorëve, të udhëheqë dhe kontrollojë të hyrat nga: Faturimi dhe inkasimi; mirëmbajtjen e të dhënave të konsumatorëve,

- Të këshillojë përmes Kryeshefit Ekzekutiv në Bordin e Drejtorëve, lidhur me progresin financiar të ndërmarrjes, planet e tanishme të biznesit dhe planet periodike dhe afat gjatë të shpenzimeve dhe aktiviteteve, fluksin e të hyrave dhe shpenzimeve,
- ZKF-zotëron planin e aktivitetit të Kompanisë të specifikuar në çdo Plan të Biznesit,
- Kërkon, propozon, gjen dhe zbaton metoda dhe mënyra për të ndërruar dhe përmirësuar metodat e punës me qëllim të përmirësimit të shërbimeve të konsumatorëve,
- Siguron se i gjithë personeli është i informuar me synimet dhe misionin e përbashkët të departamenteve, përkatësisht tërësisë së kompanisë,
- Udhëheqë personelin nënrenditës për të siguruar shërbime efektive,
- Vazhdimisht kërkon metoda dhe mënyra për të ndërruar dhe përmirësuar qasjen ndaj punës me qëllim të përmirësimit të shërbimeve të konsumatorëve,
- Për punën që kryen i përgjigjet Bordit të Drejtorëve dhe Kryeshefit Ekzekutiv.

Paga: Në pajtim me „Rregulloren për ndarjen e të ardhurave personale të KRUM-së „ të aprovuar nga Bordi i Drejtorëve.

Procedura e aplikimit:

Aplikacioni duhet bashkangjitur edhe këto dokumente:

- CV-ja (Biografia),
- Kopja e letërnjoftimit,
- Letër motivimi,
- Deklarata nën betim,
- Diploma e Universitare (kopja e noterizuar, kurse diplomat nga universiteti jashtë vendit duhet të jetë e nostrifikuar),
- Dëshmia nga gjykata kompetente që nuk është nën hetime, jo më të vjetër se 6 muaj,
- Dëshmitë e përgatitjes profesionale,
- Dëshmitë e eksperiencës në punë / referencat (duke pasur të shënuar email-adresat dhe numrat kontaktues),
- Certifikatat (nëse posedon) lidhur me njohurit në interpretimin e Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK) dhe të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), sipas udhëzimeve të Federatës ndërkombëtare të Kontabilistëve (FNK).

Aplikacioni dhe Deklarata nën Betim mund të merren në ueb-faqen e Kompanisë në adresën: <http://www.kru-mitrovica.com/kerko-me-shume/konkurset/>. Aplikacionet dhe dokumentet përcjellëse duhet të dorëzohen të skanuara ose në formatin .pdf në email adresën: rekrutimi@kru-mitrovica.com.

Konkursi do të jetë i hapur 30 ditë nga dita e publikimit në njetet e informimit.

Aplikacionet e pranuar pas afatit të paraparë nuk pranohen, kurse ato të mangëta refuzohen.

KRU "Mitrovica" Sh.A. Mitrovicë-Suhodoll.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë




www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



Kompanija Regionalnog Vodovoda
"Mitrovica" D.O.
"Ul."Jezero", b.b. 40000 Mitrovica-Suvi Do



U skladu sa funkcijama i ovlašćenjima prdvidenim Članom 21 u vezi sa članom 17 Zakona o Javnim Preduzećima (Zakon Br. 03/L-087), izmenjen i dopunjen Zakonom Br.04/L-111 i Zakonom br. 05/L-009) za Zakona o Javnim Preduzećima, Upravni Odbor i Komisije za Reviziju KRV "Mitrovica" D.O., sa sedištem u Mitrovici-Suvi Do, na sednici održanoj dana 02.03.2023 godine, odlučio da raspíše ovaj:

JAVNI KNKURS

Radno Mesto : Glavni Finacijski Zvaničnik

Mesto:Mitrovica-Suvi Do

Preduzeće: Kompanija Regionalni Vodovod., Mitrovica., D.D.

On Odgovara: Upravnom Odboru i Izvršnom Direktor KRV „Mitrovica“ D.D. Mitrovica.

Mandat: 3 godine – sa mogućnošću produženja

Uslovi i zahtevane kvalifikacije:

Upravni Odbor želi da se obezbedi da svi potencijalni kandidati budu lica sa poznatim integritetom koji ispunjavaju uslove kvalifikacija prema članu 17.1., ispunjavaju kriterijume nezavisnosti prema članu 17.2. tačka (d), (f), (k) i (l) i imaku potrebno stručno iskustvo i zahtevano školovanje za navedenu poziciju.

Osim ovih opštih uslova, kandidati treba da ispunjavaju i ove posebne uslove:

- Da ima Univerzitetsku diplomu Master Ekonomskog Fakulteta ili ekuivalent i značajno iskustvo u oblasti i/ili računovodstva.
- Diplome od stranih univerziteta teba da budu nostifikovane od strane Ministarstva prosvete, Nauke i Tehnologije;
- Da ima najmanje 5 godina radnog iskustva u dokaznom menadžmentu i/ili računovodstvu;
- Da ima visok moralni i profesionalni integritet,
- Da ima dokazne sposobnosto upravljanja,
- Poznavanje stranih jezika je prednost,
- Da ne bude osuđen ili pod istragom,
- Znanje u tumačenju Međunarodnih Računovodstveni Standarda (MRS) i Međunarodnih Standarda Finansijskog Izveštavanja (MSFI), prema uputstvima Međunarodne Federacije Računovoda (MFR) će biti prioritet;

Funkcionisanje i glavne odgovornosti Glavnog Finacijskog Zvaničnika određene Statutom Kompanije:

Glavni Finacijski Zvaničnik Društva (GFZ) će upravljati pod upravom i nadzorom IO, finacijske poslove društva, podležu graničenjima koja nameće Upravni odbor – imat će autoritet veze svih finacijskih ugovora za Društvo, i bit će odgovoran da:

Da održava račune Kompanije ažurnim i tačnim.

Da uspostavi i upravlja svim internim finansijsim kontrolama, uključujući nabavke, gotovinskog novca i osnovna sredstva. Da prai dugovanja i koordinira plaćanje računma i posebne kupovine. Da pregleda troškove zaposlenih kako bi se osigurala uskladenost sa politikama kompanije i njihovim budetom pre njihovih isplata.

Da pripremi podatke Kompanije za reviziju na kraju godine;

Da preispita postizanje sporazuma za nabavku i održavanje shih poslova vezanih sa politikama obezbeđenja;

Da koordinira ostale funkcije poslovanja, kao što su izdavanje objekata i opreme pod zakum,kao i da vrši kupovinu za EK i kancelarijom ili funkcijom nabavke kompanije.

Da menadžita trezorom Kompanije;

Da odlučuje i pripremi budete, i

I bilo koji drugi zadatak koji odredi EK.

Zadaci i odgovornosti GFZ su:

- Odgovara za sve finansijske postuake kompanije u rgiji koju pokriva kompania. .
- Obavezuje se za usku saradnju sa: Upravni Odbor i Komisije za Reviziju, Izvršnim Direktorom, Komercijalnim Direktorom, Tehničkim Direktorom i sa rukovodiocima odeljenja.
- ma za zadatak da izradi i planira budžet, da prato neslaganja . Da prai registraciju u računovodstvu, da daje savete čitavom osoblju sektora za efektivne postuake. Da prai promet gotovog noca i bankarskih transakcija.
- Preko Izvršnog Direktora o ostalog osoblja, da rukovodi sa preduzećem pred stranama interesa (Bord Direktora-Akcionari, Opština, Donatori). Da obezbedi rakun po potrebi koji se zahtevaju za izveštavanje preduzeća.
- Preko podređenog osoblja, posebno izvršnog direktora prodaje, i u uskoj saradnji sa izvršnim direktorom usluga potrošača, da rukovodi i kontroliše prihode od: Fakturisanja i inkasiranja, odražavanje podataka potrošača.
- Da savetuje preko Glavnog Izvršnog Direktora u Upravnom Odboru, u vezi sa finacijskim progresom preduzeća, sadašnje planove poslovanja i periodične i dugoročne planove trokova i aktivnosti, tok prihoda i rashoda.
- GFZ-poseduje poslovni plan Kompanije specifikovane u vaki Plan

- Zahteva, predlaže, namazi i sprovodi metode i načine za promenu i popravku metoda rada sa namerom poboljšanja usluga potrošača.
- Obezbeđuje da svo osoblje bude informisano sa namerama i zajedničkom misijom odelenj, odnosno celine kompanije,
- Vodi podređeno osoblje kako bi osigurali efikasne usluge,
- Stalno traži metode i načine da prometi i popravi pristup prema radu sa namerom popravljjanja usluga potrošača.,
- Za obavljene posao odgovara Upravnom Odboru i Glavnom izvršnom Direktor.

Plata: U skladu sa "Pravilnikom o raspodeli ličnih primarja KRVM" usvojeno od strane Upravnog Odbora. .

Procedura aplikacije:

Aplikaciji treba priložiti i sledeća dokumenta:

- CV-ja (Biografija),
- Kopija lisne karte,
- Motivaciono pismo,
- Izjava pod zakletvom,
- Univerzitetska Diploma (notarizovana kopija, dok diplome sa univerziteta van zemlje treba da budu nostrifikovane),
- Dokaz od i nadležnog suda da nije pod istragom, ne starija od 6 meseci,
- Dokazi o stručnoj spremi,
- Dokazi o radnom iskustvu/ reference (navodeći imejl adrese i kontakt brojeve)
- Sertifikati (ukoliko ih poseduje) u vezi sa Znanjem u tumačenju Međunarodnih Računovodstvenih Standarda (MRS) i Međunarodnih Standarda Finansijskog Izveštavanja (MSFI), prema uputstvima Međunarodne Federacije Računovoda (MFR) će biti prioritet;

Aplikacije mogu da se uzmu u direkciji Kompanije (ili veb-stranici Kompanije) na adresi : <http://www.kru-mitrovica.com/kerko-me-shume/konkurset/>. Aplikacija i prateća dokumenta treba da se predaju skenirano ili u .pdf formatu na mejl adresu: rekrutimi@kru-mitrovica.com

Konkurs će biti ovoren 30 dana od dana objavljivanja u sredstvima informisanja. Prijave podnete nakon roka se ne prihvataju, a nepotpune se odbijaju..

KRV"Mitrovica"D.D. Mitrovic-Suvi Do.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Fitim Mackaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl: VI - IX SHFMU "Mic Sokoli" Lubiqevë.

NaserMackaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl: VI - IXSHFMU "Mic Sokoli" Lubiqevë.

Rita Lekaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12. dhe diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi".

- Urgjentisht kërkohet një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

- Lëshoj lokalim më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

